*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

E hënë, 22 nëntor 2021

[Seancë e hapur]

[I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

--- Fillon në orën 09.32

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti Sekretar, ju lutem thërrisni çështjen.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Është çështja KSC-BC-2020-05, Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Shumë mirë.

Së pari do të dëgjojmë përfaqësuesit e palëve.

Zonja Prokurore, keni fjalën.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirëmëngjes dhe faleminderit. Zyra e Prokurorisë përfaqësohet nga Prokurori Cezary Michalczuk; Ndihmësprokurori Filippo De Minicis, Përgjegjësja e Çështjes Julie Mann; dhe stazhiere Julie [sipas përkthimit] Osborne; dhe, unë vetë Silvia D’Ascoli Ndihmësprokurore. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtës i Viktimave.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit. Mirëmëngjes, të nderuar. Mirëmëngjes, të gjithëve.

Ne përfaqësohemi nga Njomza Haxhibeqiri, ndihmësja ime dhe unë vetë Anni Pues, si Mbrojtëse e Viktimave.

Faleminderit.

Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar. Mbrojtja përfaqësohet nga Betim Shala dhe Fatmir Pelaj, unë Julius Von Bone. Dhe zoti Mustafa që është duke na ndjekur nga larg.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti Mustafa, na dëgjoni mirë?

I AKUZUARI MUSTAFA: [Përmes videolidhjes] Po, zonja Gjykatëse.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Dhe për procesverbal jeni përpara Trupit Gjykues numër I.

Sot do të dëgjojmë dëshminë e Dëshmitarit 4391, dëshmitar i Prokurorisë, dua të filloj menjëherë me këtë.

Z. VON BONE: [Përkthim] Duam të ngremë, me lejen tuaj, një çështje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E shoh që edhe Prokuroria është ngritur në këmbë.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Edhe ne duam të ngremë një çështje paraprake, por duam ta bëjmë këtë në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti Von Bone, e doni ta ngrini në seancë publike apo private?

Z. VON BONE: [Përkthim] Do ta bëjmë në seancë publike. Nuk e di nëse do të flasim për të njëjtën çështje, zonja Prokurore?

Problemi që kemi ne është parashtrimi i 19 nëntorit me

anë të cilit kërkohet zbatimi i rregullit 153(1). Po shoh Prokuroren nëse bëjmë fjalë për të njëjtën çështje, nuk e di.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, nuk është e njëjta çështje. Po dhe ne kemi një komunikim për të bërë lidhur me të njëjtin parashtrim.

Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë. Atëhere po vazhdoj.

Të nderuar Gjykatës, nuk jemi të sigurtë se kur do të jetë e nevojshme të reagojmë për këtë gjë. Sipas planit që kemi këtë javë, ne do të kërkonim lejen tuaj për ta ngritur këtë çështje.

Gjithsesi, Mbrojtja e kundërshton kërkesën e Prokurorisë, ky është thelbi i çështjes sonë, në veçanti çështja ka të bëjë me këtë.

Sikundër thotë rregulli 153, Trupi Gjykues mund të pranojë një deklaratë me shkrim të një dëshmitari që provon një çështje të ndryshme nga veprimet dhe sjellja e të akuzuarit. Ne e gjejmë këtë kërkesë shumë të vakët lidhur me çfarë çështje konkrete kjo kërkesë do të trajtonte.

Duhet të shkojmë në seancë private?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani duam që të bëni një parashtrim dhe jo një parashtrim me gojë, parashtrim me shkrim.

Unë e kam shënuar këtu për vete, që ju keni kërkuar se kur duhet ta dorëzoni parashtrimin në bazë të këtij rregulli.

Bëhet fjalë për datën 1 dhjetor. 1 dhjetori është i bëshëm për ju, të themi? Sepse i bie javës tjetër. Ne sot jemi në datën 22. Jo, do të ishte e mërkura e javës që vjen. Atëherë, ju duhet të dorëzoni një parashtrim për këtë çështje.

Z. VON BONE: [Përkthim] Me lejen tuaj, do të ishte në rregull në qoftë se do ta bënim të premten. Do të kishim pak më shumë kohë, se kemi disa zhvillime të tjera. Ndërkohë të cilat do të na mundësonin t'i përgjigjshim në kohën e duhur. Megjithatë, do të duam që të jemi të qartë për çështjen konkrete që parashikohet këtu, për të cilën bëhet fjalë këtu në këtë kërkesë. Kjo është pak a shumë ajo që kërkojmë. Ose mund ta bëjmë, pra, me gojë kur të përcaktohet me saktësi, ndryshe e dimë të paktën ku jemi.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Lidhur me zgjatjen e kohës, arsyeja që kërkoni dy ditë më shumë, arsyetimi minimal do të ishte i nevojshëm në këtë rast.

Z. VON BONE: [Përkthim] Ne e kemi programin e ngjeshur këtë javë. Kemi dhe disa çështje të tjera lidhur me hetimet, si të them, disa çështje për të cilat s'kemi shumë kohë për t'i mbuluar. Pra, është një javë që kemi seancë çdo ditë, kështu që ne punojmë dhe gjatë javës të hënë, të martë, - e mërkura është pak si shpejtë. Ne do të përpiqemi megjithatë për ta bërë të mërkurën. Por nëse është e mundur ta shtynim, do të na ndihmonte shumë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duhet

të keni arsye të forta për këtë gjë, unë ju dëgjova e kuptoj se ç'kërkoni. E mbajta shënim këtë që thatë. Faleminderit.

Zonja Prokurore, të kërkoj të futem në seancë private apo doni të flisni lidhur me këtë parashtrim në publik?

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkurtimisht dua të shtoj se do të ketë një shtojcë për këtë parashtrim, që do ta paraqesim, ku do të themi arsyet për kërkesën që u urdhërua dhe nga Trupi Gjykues. Por thelbi është parashtruar në parashtrimin kryesor.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

Zonja Sekretare, të kalojmë në seancë private.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Zonja Prokurore, keni fjalën.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

Nëse ka dikush që dëshiron të komentoj?

Mbrojtësja e Viktimave.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo. Prokuroria e mbuloi gjerë e gjatë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtës doni të thoni diçka?

Z. VON BONE: [Përkthim] Jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

Tani kalojmë përsëri në seancë publike.

Ju lutem, të kalojmë në seancë publike, Sekretar.

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Faleminderit shumë. Atëhere do të fillojmë me dëshmitarin e Prokurorisë 4391.

Sekretar, ju lutem silleni dëshmitarin në sallën e gjyqit.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni, ju lutem.

Zoti dëshmitar, unë jam përpara jush, siç më shikoni, po flas. Ja ku jam këtu. Mirëmëngjes.

DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se keni ardhur në Dhomat e Specializuara.

DËSHMITARI: Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Besoj që më dëgjon mirë?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Si jeni, pikë së pari?

DËSHMITARI: Mirë, faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, zoti dëshmitar sot do të fillojmë me dëshminë tënde dhe përpara se të fillojmë kam disa gjëra për të thënë.

Së pari, do të shpjegoj masat mbrojtëse të cilat janë miratuar për ty, për dëshminë që do të japësh këtu. Të është caktuar një pseudonim, që do të thotë që emrin tënd nuk do ta

përmendim asnjëherë por do të të drejtohemi me fjalët "Zoti dëshmitar" me qëllim që publiku të mos ta mësojë emrin tënd. Gjithashtu do ta shtrembërojmë dhe zërin dhe fytyrën që do të thotë që asnjeri jashtë kësaj salle gjyqi, që i ndjek punimet, nuk do ta shikojë fytyrën dhe nuk do ta dëgjojë zërin tënd të vërtetë gjatë dëshmisë tënde këtu.

Kur t'i përgjigjesh pyetjeve për të mos nxjerrë identitetin tënd, do ta bëjmë në seancë publike që do të thotë që publiku e dëgjon këtë që do të themi, por kur të kërkojnë të shpjegosh diçka që ka të bëjë konkretisht me ty apo të përmendësh fakte të cilat mund të nxjerrin në pah identitetin tënd, këtë do ta bëjmë në seancë private, që do të thotë nuk do transmetohet dhe asnjeri jashtë kësaj salle gjyqi nuk do ta dëgjoj këtë që po themi. Në qoftë se thuhet diçka në seancë të hapur që mund të të identifikoj do ta heqim atë pjesë, këtë informacion. Dëshmia jote do të transmetohet më vonë, kështu që kemi kohë të heqim diçka që është thënë pa dashje që mos ta dëgjojë publiku dhe nga transkriptit e procedurës këtu.

Gjithashtu përveç masave mbrojtëse, janë marrë dhe tre masa të tjera me kërkesën e Zyrës për Mbrojtjen e Dëshmitarëve sipas rregullit 80 paragraf 4(c) dhe rregullit 5. Dhe këto masa janë: Prania e një psikologu këtu gjatë dëshmisë tënde; dhe ndihmë nga një anëtar i stafit që do të të rrijë pranë; do t'ju japin ndihmë kur të keni nevojë, nëse keni nevojë për të lexuar diçka: dhe për t'i përshtatur pyetjet sipas nevojës, që

do të thotë, palët dhe Avokati i Viktimave do të bëjnë çmos që të bëjnë pyetje të thjeshta, të qarta që të mos të të ngatërrojnë. Nuk do të përdorim pyetje të përsëritura gjatë pyetjeve që do të bëjmë. Dhe vendimi i Trupit Gjykues i është bërë i njohur palëve dhe Avokatit të Viktimës me një email që mban datën 19 nëntor 2021 në 3.00 pa katër minuta.

Tani këto masa që të shpjegova, dëshmitar, a janë të qarta për ty?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë, zoti dëshmitar.

Dhe përsëris gjithmonë, për të gjithë ne që jemi këtu, duhet të bëjmë shumë përpjekje për të respektuar masat mbrojtëse gjatë pyetjeve që do të bëjmë që të mos nxjerrim asnjë informacion konfidenciale.

Po ju kujtoj që seanca po mbahet në seancë të hapur përveçse kur Trupi Gjykues vendos ndryshe dhe ju kujtoj të gjithëve rregullat në sallë të gjyqit.

Tani, zoti dëshmitar, po të drejtohem ty. Ti do të deponosh këtu në çështjen kundër Salih Mustafës për të na ndihmuar ne si Trup Gjykues që të marrim një vendim. Pasi të bësh deklaratën solemne për të thënë të vërtetën do të bëjë pyetje Prokuroria, që është në anë e tënde të majtë. Siç e shikoni. Pastaj janë avokatët që përfaqësojnë viktimën. E keni aty ekipin e Mbrojtjes së Viktimave. Ndërsa nga ana tjetër

janë Avokatët e Mbrojtjes, ekipi i z. Mustafa. Në anën tjetër. Kurse ne këtu jemi Gjykatësit e Trupit Gjykues edhe ne në fund do të bëjmë pyetje mbasi të kenë përfunduar pyetjet e palëve.

Tani, dua të japë disa udhëzime që përgjigjesh pyetjeve që do të bëjnë. Të lutem, zoti dëshmitar, dëgjoji me kujdes pyetjet, kur nuk e kupton pyetjen mos hezito që të kërkosh që ta përsërisin pyetjen. Ne duam që ti të na thuash të vërtetën, të na thuash atë që ke parë, atë që ke dëgjuar, atë që ke përjetuar apo ke ndjerë vetë. Në qoftë se nuk e ke parë vetë, nuk e ke dëgjuar vetë, por e ke mësuar në një mënyrë tjetër të lutem, na e thuaj këtë dhe na shpjego sesi e ke mësuar. Mos iu përgjigj pyetjeve që të bëjnë duke iu referuar ndonjë deklarate të mëparshme që i ke dhënë Prokurorisë apo dikujt tjetër. Duam që t'u përgjigjesh pyetjeve plotësisht që do t'ju bëhen këtu përpara nesh Trupit Gjykues.

Mbase ty nuk do të kujtohen të gjitha hollësitë e atyre ngjarjeve dhe nuk ka asnjë problem. Dëshmo vetëm për ato që ti kujton, që mban mend, mos hamendëso. Nuk ka problem të thuash "Nuk e di", "Nuk e maj mend".

E kuptoj që po pohon me kokë.

Pra, me sa po kuptoj që ju i keni kuptuar këto ju thashë?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Tani, dua të të japë disa këshilla praktike për dëshminë që do japësh.

Zoti dëshmitar, të gjitha që ne themi këtu përkthehen dhe regjistrohen, pra, ka rëndësi të flasësh pranë mikrofonit, të flasësh qartë dhe me një ritëm të ngadaltë, jo shpjet, pra, me qëllim që përkthyesët të kenë mundësi të përkthejnë gjithçka. Duhet të fillosh të flasësh vetëm kur personi që të bën pyetjen ta ketë përfunduar pyetjen. Pra, kur të bëhet një pyetje, të lutem, me kokë, me mendje numëro deri në pesë dhe vetëm atëherë jepe përgjigjen. Pra, këto pesë sekonda na ndihmojnë që të dëgjojmë mirë atë që do thuash të cilat do përkthehen, do regjistrohen.

Nëse ke ndonjë pyetje, nëse ke nevojë për ndonjë pushim apo ke nevojë për ndihmë, të çfarëdo lloji qoftë, në çdo kohë, të lutem, ngri dorën me qëllim që unë ta di se ke nevojë të thuash diçka.

I ke kuptuar të gjitha këto që të thashë, zoti Dëshmitar.

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Faleminderit.

Ashtu siç bëjmë me të gjithë dëshmitarët, tani do të lutem të lexosh deklaratën solemne për të thënë të vërtetën. Dhe po të kujtoj që është vepër penale në qoftë se jep të rreme si mbas juridiksionit të Gjykatës.

Sekretar, ndihmoje dëshmitarin, jepja deklaratën solemne për ta lexuar.

Të lutem, zoti dëshmitar lexojë atë fletën që ta ka

dhënë.

DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: W04391

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, zoti dëshmitar.

Tani je betuar të thuash të vërtetën.

Tani, mund të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit 4391, do të filloj Prokuroria.

Ju keni thënë që ju duhen katër orë për të pyetur këtë dëshmitar dhe e shikoj që e pohoni me kokë. Nëse keni ndonjë ndryshim, bëni ndonjë ndryshim na njoftoni.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do t'ju njoftoj.

Pyetje nga zonja D'Ascoli:

Py. Mirëmëngjes, zoti dëshmitar.
Pë. Mirëmëngjes.
Py. Unë jam Prokuroria që do të udhëheq pyetjet që do të bëjnë sot për ju.

Zonja Kryetare e Trupit Gjykues, t'i shpjegoi masat mbrojtëse që janë marrë në rastin tënd dhe si ne do të kalojmë nga seanca e hapur në private sipas pyetjeve. Dhe do të shpjegoj kur të jemi në seancë të hapur, për të qenë i kujdesshëm kur të përmendësh disa gjëra me qëllim që të bëjmë

maksimumin e kujdesit për të mbrojtur informacionin identifikues.

Gjithashtu po të kujtoj se kur nuk e kupton ndonjë nga pyetjet që do të bëj apo në se do që unë të ta përsëris, mos nguro të ma thuash një gjë të tillë.

Pë. Në rregull.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të kalojmë në seancë private për pyetjet e para të pyetjeve që kemi sepse janë informacione identifikues.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sekretar, të kalojmë në seancë private.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Zonja Prokurore, keni fjalën prapë.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

Py. Zoti Dëshmitar, po filloj së pari me hollësitë personale të tua. Thuaje si të quajnë, për procesverbal.

Pë. Emrin e vërtetë?

Py. Po, po. Jemi në seancë private, këtu s'ka problem. Asnjëri jashtë kësaj salle gjyqi nuk e dëgjon këtë që do themi. Edhe emrin edhe mbiemrin, të lutem.

Pë. Quhem *[REDAKTUAR]*

Py. A mund të na thuash kur je lindur?

Pë. Më të *[REDAKTUAR]*
Py. Po babain si ta quajnë, të lutem?
Pë. *[REDAKTUAR]*
Py. Në rregull. Zoti Dëshmitar, tani do të bëj disa pyetje për vitin 1999, për gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Prapë vazhdojmë në seancë private, kështu që mos u shqetëso kur të tregosh informata që mund të jenë personale apo identifikuese.
Të kujtohet ku ke banuar në prill të vitit 1999?
Pë. Po.
Py. Ku ke banuar?
Pë. Në *[REDAKTUAR]*
Py. Ishte banesa juaj e përhershme aty?
Pë. Jo.
Py. Ku banonit zakonisht?
Pë. *[REDAKTUAR]*
Py. Pra, banesa e kujt ishte kjo aty ku po rrinit në *[REDAKTUAR]*, në prill të 1999-s?
Pë. Ishte shtëpia e *[REDAKTUAR]*.
Py. Kush ishte *[REDAKTUAR]*?
Pë. Pronari i shtëpisë ku kena qëndru na.
Py. E shikoj që keni të *[REDAKTUAR]*. Keni pasë ndonjë *[REDAKTUAR]* me të?
Pë. Jo.
Py. Pra, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*?

Pë. Jo.
Py. A mund të na thuash me kë keni qenë aty? Përveç jush kush ka qenë aty?
Pë. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Py. Ti vetë, a ke qenë ndonjëherë anëtar i UÇK-së, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në vitin 1999?
Pë. Jo.
Py. Ju lutem, prisni një moment deri sa të mbaroj pyetjen unë kur të jepni përgjigjen, të dëgjoni dhe përkthimin në mënyrë që të japim pak më tepër kohë për përkthyesit edhe në mënyrë që të mos ketë mbivendosje.
Pë. Më fal.
Py. Jo, nuk ka nevojë të kërkoni falje.
*[REDAKTUAR]*, a ka qenë ndonjëherë pjesëtar i UÇK-së?
Pë. Jo.

Py. A e di në qoftë se ka pasur njësi të UÇK-së që funksiononin në zonën tuaj, domethënë, përmes nga *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* në vitin 1999 në këtë zonë?
Pë. Po.
Py. Dhe a e dini se cilat ishin këto njësi specifike të veçanta?
Pë. Nuk kuptoj.
Py. A e dini, sepse ti sapo na the, që kishte njësi të UÇK-së që *[REDAKTUAR]* dhe pyetja që bëra unë pas kësaj ishte në qoftë se ishin në dijeni se cilat ishin këto njësi?
Pë. Po. Ka qenë një njësi në fshatin *[REDAKTUAR]*.
Py. A e di ti se cila ishte njësia konkrete funksionet, emri? Në qoftë se e mban mend. Në qoftë se s'e mban mend nuk është problem.
Pë. Po ka qenë njësia e Brigadës 153 e fshatit Zllash.
Py. A ke qenë ti në dijeni të mënyrës sesi ishte organizuar UÇK-ja në zonën tënde, domethënë, përveç emrit të njësisë dije ndonjë gjë tjetër?
Pë. Jo.
Py. A e dije ti që kishte ndonjë njësi tjetër përveç brigadës 153 që sapo na përmende?
Pë. Jo. Nuk më kujtohet.
Py. Në rregull. Zoti dëshmitar, çfarë të ndodhi ty në prill të vitit 1999, në qoftë se të ka ndodhur ndonjë gjë, ndërkohë

që ishit në *[REDAKTUAR]*
Pë. Po, më kujtohet dita e 1 prillit 1999.
Py. Çfarë ndodhi më 1 prill 1999?
Pë. Me cekë në emër?
Py. Po. Mund ta cekësh në emër se jemi akoma në seancë private, kështu që askush tjetër përveç kësaj salle gjyqi nuk na dëgjon se çfarë po themi.
Pë. Në rregull.
Rreth orës 11.00 të ditës të paradites, kanë ardhur tre persona në fshatin *[REDAKTUAR]* ku kena jetu. Unë kam qenë në rrugë. Më kanë pyetur për *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Personat kanë qenë *[REDAKTUAR]*, nga fshati *[REDAKTUAR]*, po ai nga fshati *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* po -- *[REDAKTUAR]* po nga fshati *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Më kanë pyetur për të ndjerin se ku gjendet *[REDAKTUAR]* Unë i kam tregu që gjendet në fshatin *[REDAKTUAR]* në shpi. Ata kanë vazhduar rrugën.
Py. A të shpjeguan ty ata se pse po e kërkonin *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*
Pë. Jo.
Py. Këta persona a ishin persona që ti i njihje?
Pë. Po.
Py. Në çfarë cilësie erdhën ata për të takuar ty?
Pë. Nuk e di. Kanë ardhur me një Mercedes të gjelbër, katër dyersh. Mendoj që ka qenë Mercedes 200. Me uniformë të UÇK-së.

Py. A e di ti se në çfarë njësie bënin pjesë ata?
Pë. Nën njësinë 154 -- 153.
Py. A e mban mend se çfarë ngjyre kishin uniformat që kishin veshur?
Pë. Po. Ngjyrë të zezë me emblemë të UÇK-së.
Py. Cilët *[REDAKTUAR]*, në qoftë se të kujtohet, ishin të pranishëm kur mbërritën këta tre burra?
Pë. Ata njëherë kanë qenë *[REDAKTUAR]*. I kanë pyet *[REDAKTUAR]* Tani kur kanë dalë, unë kam qëlluar në rrugë. Po ça kanë folë *[REDAKTUAR]*, më duket ju kanë thënë "A doni ndihma?", nëse kuptohmi.
Py. Me kë ishe ti kur u takove me ta?
Pë. Unë isha me një shok timin.
Py. A e mban mend se *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Pë. Po, *[REDAKTUAR]*
Py. Në rregull.
Kur këta tre burra të pyetën se ku është *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* a të treguan ndonjë dokument, ndonjë letër?
Pë. Jo.
Py. Ti the se ti e dije se këta burra ishin pjesë e Brigadës 153. A e di ti se në çfarë pozite, çfarë pozicioni kishin ata. Ti përmende për shembull *[REDAKTUAR]*, a dije se çfarë

pozicioni zyrtar kishin ata brenda UÇK-së?
Pë. Po *[REDAKTUAR]* e kam njoftë edhe ma herët. Ai e ka luajtur rolin si *[REDAKTUAR]* të Brigadës 153 në Zllash.
Py. Pra, këtë mbani mend. Këtë mban mend vetë ti. Këtë njohuri ke ti lidhur me rolin e tij; apo jo?
Pë. Po.
Py. Çfarë u the ti atyre kur ata të pyetën për *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*
Pë. I tregova se gjendet në shtëpi në fshatin *[REDAKTUAR]*
Py. Po më pas çfarë bënë ata?
Pë. Vazhduan rrugën.
Py. A e di se çfarë ndodhi më pas pasi u larguan, pasi vazhduan rrugën?
Pë. Të nesërmen e kam kuptuar.
Py. A e di në qoftë se, në fakt, ata shkuan në *[REDAKTUAR]* apo jo për të kërkuar *[REDAKTUAR]*
Pë. Jo, nuk e kam ditur.
Py. Kur nuk e ke ditur që ata kanë shkuar në *[REDAKTUAR]* apo jo?
Pë. Atë ditë.
Py. A mësuat në ndonjë pikë të caktuar kohe që në fakt ata shkuan në *[REDAKTUAR]* për të kërkuar *[REDAKTUAR]*?
Pë. Jo, të nesërmen e kam kuptuar.
Py. A mund të na thuash se çfarë mësuat lidhur me këtë dhe nga kush e mësuat? Kush jua tha këtë gjë?
Pë. Të nesërmen kam shkuar unë në shtëpi, në *[REDAKTUAR]* Jam

takuar me *[REDAKTUAR]*, i cili më tha "Dje e kanë rrëmbyer *[REDAKTUAR]* tre persona. Ka qenë *[REDAKTUAR]* me dy tjerë". *[REDAKTUAR]* i ka pyetur "Arsyen që e merrni". "Kena një intervistë me ja bë dhe e lirojna".

Py. Në rregull. A ke bërë ndonjë përpjekje ti për të gjetur *[REDAKTUAR]*, pasi e mësuat këtë që kishte ndodhur këtë nga *[REDAKTUAR]*

Pë. Po.

Py. Çfarë bëtë?

Pë. Të nesërmen kam shkuar me *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*, në fshatin *[REDAKTUAR]*. Jam takuar me *[REDAKTUAR]*. Në *[REDAKTUAR]* ka qenë një pikë e UÇK-së në fshatin *[REDAKTUAR]*, aty jam takuar me *[REDAKTUAR]*. Kam biseduar për *[REDAKTUAR]*. E kam pyetur se "arsye që e keni marrë". *[REDAKTUAR]* na u ka përgjigj "se e i kem veç do pyetje me të. Kena me e marrë në intervistë edhe e lirojna".

Py. A mban mend se ku ishte ky posti i UÇK-së në fshatin e *[REDAKTUAR]*

Pë. Po.

Py. Ku ishte?

Pë. *[REDAKTUAR]*

Py. A të kujtohet se çfarë pike kontrolli e UÇK-së ishte kjo?

Pë. Ka qenë afër rrugës në anën e majtë, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Aty kanë qëndruar pesë-gjashtë ushtarë apo dhjetë, në mesin e tyre ka qenë edhe

*[REDAKTUAR]*

Py. A e dije ti, a ishe në dijeni, të gjitha vendndodhjeve ose punkteve të ndryshme të UÇK-së që ekzistonin në zonën tuaj?

Pë. Në fillim jo.

Py. Pse shkove ti atje? Pse shkove për t'u takuar specifikisht apo konkretisht me *[REDAKTUAR]*?

Pë. Për ta kërkuar *[REDAKTUAR]*

Py. Shkove sepse e dije, sepse e patë atë dhe sepse *[REDAKTUAR]* ju tha që *[REDAKTUAR]* ishte një ndër personat që e *[REDAKTUAR]*? Për këtë arsye shkuat për t'u takuar me të?

Pë. Po.

Py. Në këtë rast, kur ju dha arsyet se pse e kishin marrë *[REDAKTUAR]* a të tregoj ty ai ndonjë dokument, ndonjë urdhër-arresti për të justifikuar marrjen e *[REDAKTUAR]*?

Pë. Jo. Megjithëse gjithë[një] ia kam kërkuar fletë-arrestin. Ai m'u ka përgjigj "Është urdhër".

Py. A të përmendi se kush e kishte dhënë këtë urdhër apo thjesht të tha që ishte urdhër?

Pë. Jo, nuk e ka përmend. Veç me fjalë "Është urdhër".

Py. Çfarë ndodhi më pas? Çfarë bëre ti pas takimit me *[REDAKTUAR]*

Pë. Jemi kthyer. Atë ditë jemi kthyer *[REDAKTUAR]* me *[REDAKTUAR]*

Py. Po më vonë a bëre ndonjë përpjekje tjetër për të gjetur

*[REDAKTUAR]*
Pë. Po.
Py. A mund të na tregosh pak se çfarë bëre?
Pë. Të nesërmen, më 5 prill 1999, ka qenë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* kena shku në fshatin *[REDAKTUAR]* S'kanë ndalë hiç, s'na ka ndalë kërrkush. Kena vazhdu rrugën për në Zllash. Rrugën *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* e kena taku *[REDAKTUAR]* me një xhip të zi me nja tre-katër ushtarë. Na ka ndalu *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*
Py. Ti the që shkuat në *[REDAKTUAR]* dhe që vazhduat rrugën për në Zllash dhe se ndërmjet këtyre dy vendeve u takuat me *[REDAKTUAR]*
Pyetja ime për ju është kjo: Pse ishit nisur për të shkuar në Zllash?
Pë. Se unë ma herët i kam pyetur fshatarët ku gjendet shtabi i UÇK-së përveç në fshatin *[REDAKTUAR]* Ata më kanë treguar që gjendet në Zllash.
Py. A kishe qenë ndonjëherë më përpara në Zllash ti?
Pë. Jo, kurrë.
Py. A e dije ti se ku gjendej ky shtabi për të cilin të treguan njerëzit? A e dije se ku gjendej shtabi?
Pë. Në atë kohë nuk e kam ditur.
Py. Pra, ti ishe rrugës për në Zllash sepse e dije që kishte një shtab të UÇK-së atje?

Pë. Po.
Py. Çfarë doje ti të bëje në Zllash?
Py. Jeni taku me *[REDAKTUAR]* me një xhip të zi rrugës së *[REDAKTUAR]*, siç e thashë më herët, e ka ndal xhipin dhe *[REDAKTUAR]* ka zbrit në tokë. I kena kërku "A mujna me pa *[REDAKTUAR]* se sot e *[REDAKTUAR]* na ka thënë "*[REDAKTUAR]* është në zonën e *[REDAKTUAR]* UÇK".
Kena fol do fjalë me të edhe e ka kapë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* prej *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* në xhip. Unë e kam kërcy e kam *[REDAKTUAR]* Nuk e kam lanë me i marr i kam thënë "*[REDAKTUAR]* nuk mundesh me e marrë". *[REDAKTUAR]* na u kthy me fjalë "Kurrë më s'do ta shihni *[REDAKTUAR]* Kolegët e tij e kanë ndalë i kanë thënë "*[REDAKTUAR]* leje. Hajde, vazhdojna rrugën". Na kanë lanë në q'atë rrugë dhe ata kanë vazhdu rrugën.
Py. Në rregull. Pra, kjo ndodhi në rrugë ndërmjet *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* apo jo?
Pë. Po.
Py. A e vazhduat rrugën për në Zllash atë ditë apo jo?
Pë. Na atë ditë jo.
Py. Si do të shkonit? *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*
Pë. Jo, *[REDAKTUAR]*.
Py. A e dinit se ku do të shkonit ekzaktësisht, saktësisht?

Pë. Jo.

Py. Pra, e kuptoj këtë që thatë, që vetë nuk e dinit se ku ishte shtabi i njësive të UÇK-së, se ku gjendej shtabi i njësive të UÇK-së në Zllash, apo jo?

Pë. Unë nuk e kam ditur.

Py. Çfarë ndodhi më pas?

Pë. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Py. *[REDAKTUAR]* ku po qëndronit, që na the më përpara?

Pë. Po.

Py. Pra, e kuptoj që *[REDAKTUAR]* ishte personi që shkoi për të kërkuar leje që *[REDAKTUAR]* të lirohej në mënyrë që të merrte pjesë në *[REDAKTUAR]*. Thjesht po e shpreh ndryshe atë çfarë dhatë ju në përgjigje të pyetjes tonë në rreshtat 17 deri në 21 të transkriptit të ditës së sotme, sa për procesverbal. Domethënë, ishte *[REDAKTUAR]*, ai personi që shkoi për të kërkuar që të vinte *[REDAKTUAR]*

Pë. Po. Po.

Py. Ti vetë nuk ke qenë me të; apo jo?

Pë. Jo.

Py. Do të vazhdojë të bëjë pyetje lidhur me gjërat që ke bërë ti vetë, personalisht, dhe gjërat që ke përjetuar ti vetë personalisht.

Ti personalisht, a ke bërë përpjekje të tjera për të gjetur *[REDAKTUAR]*

Pë. Po.

Py. A mund të na thuash rreth kësaj gjëje?

Pë. Po. *[REDAKTUAR]*, unë kam shkuar në këmbë në fshatin Zllash dhe kam gjetur shtabin e UÇK-së. Në hyrje më ka ndalë roja i shtabit. Po. Unë i kam kërkuar -- kam biseduar me të, kam kërkuar se a mund të takohem me *[REDAKTUAR]*. Roja ka qenë, nëse s'gaboj *[REDAKTUAR]*, emri saktë nuk më kujtohet tash. Më ka thënë se duhet të bëni një kërkesë për t'u takuar me *[REDAKTUAR]*. Jam kthyer një shtëpi.

Të nesërmen, e kam shkruar kërkesën dhe prapë të njëjtit person ia kam dërguar. Ai më ka thënë vjen e merr mbas dy dite përgjigjen. Prapë kam shkuar mbas dy ditëve. Nuk mu ka kthyer përgjigjja. Jam kthyer në shtëpi. Më ka thënë se *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* gjendet ushtar *[REDAKTUAR]* në UÇK.

Prapë më ka thënë duhet të shkruani prapë një kërkesë. Pas dy-tri ditësh, s'më kujtohet saktësisht, jam shku e kam shkruar edhe një kërkesë jam ta ku në hyrje me *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*. Prapë *[REDAKTUAR]* më ka thënë ta shkruaj një kërkesë. E kam shkruar kërkesën, e kam dorëzuar mbas dy ditë -- të nesërmen apo mbas dy ditëve më ka

thënë "Hajde mbas dy dite e merr përgjigjen". Dhe nuk kam marrë kurrfarë përgjigje.
Py. Në fillim të përgjigjes në rreshtin 15, ti që ditën pas *[REDAKTUAR]*, që ju thatë që ju kishte ndodhur ajo *[REDAKTUAR]* ju shkuat për të vizituar shtabin e UÇK-së.
A ishte hera e parë kjo që shkonit në Zllash dhe që vizitonit një vend të UÇK-së në Zllash?
Pë. Po, hera e parë ka qenë.
Py. Pra, do të thuash që ky nuk ishte një vend që e njihnit më përpara apo jo?
Pë. Kurrë s'kam qenë në jetën time deri atë ditë në fshatin Zllash.
Py. Zoti dëshmitar, a ka pasur një ofensivë serbe në zonën tuaj në prill ose rreth prillit nëse e kujtoni?
Pë. Po.
Py. E di që ka kaluar shumë kohë. A mund të përpiqesh që të na thuash se në çfarë kohe në prill ka ndodhur në fillim, në mes, në fund? Në qoftë se mundesh gjithmonë.
Pë. Nëse më kujtohet, më falni, ka kaluar kohë shumë e gjatë, nëse më kujtohet dikund 19 prilli ka qenë ofensiva e serbëve në fshatin Zllash.
Py. A e mban mend se ku ishe ti në kohën e ofensivës më datë 19 prill ose rreth asaj date?
Pë. Po. Jena kthy në *[REDAKTUAR]* në shtëpinë tonë *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
Py. Çfarë ndodhi atë ditë, në qoftë se mban mend ndonjë gjë më konkretisht?
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Py. A i njihje ti këta njerëz? Njihje ndonjërin prej tyre?
Pë. Po. Një e kam njoftë.
Py. A e mban mend -- ua mban mend emrat? Jemi në seancë private kështu që mund t'i thuash emrat.
Pë. Po. Një e mbaj mend, *[REDAKTUAR]*. Jeton në *[REDAKTUAR]* Nëse më kujtohet, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Edhe disa persona të tjerë që nuk jua di emrat.
Janë kanë dikund shtatë apo dhjetë persona nga burgu i Zllashit që kanë ardhur në *[REDAKTUAR]*. Janë ushqy dhe janë shku.
Py. A munde ti me i mësu emrat e personave të tjerë dhe mos rastësisht të kujtohen se cilët ishin këta emra?
Pë. Jo. Nuk më kujtohen.
Py. Nuk ka problem. Nga vinin këta njerëz? Ti sikur the Zllashi, nga Zllashi? A mund të na thuash se ç'mësove prej tyre?
Pë. Po. Ata kanë ardhur nga burgu i fshatit Zllash, të cilët kanë qenë në burg me *[REDAKTUAR]*.
Py. Si i mësove ti këto detaje?

Pë. Ata na kanë tregu.
Py. Përveç faktit që po vinin nga burgu a të thanë ndonjë gjë tjetër? Të thanë ndonjë gjë tjetër, ndonjë gjë konkrete?
Pë. Po.
Py. Na thuaj ato që mban mend. Nëse mban mend diçka.
Pë. Po. Ne i kena pyetur për të ndjerin se, a e keni pa
*[REDAKTUAR]*
Pë. Ata na u kanë përgjigj "Po".
Py. A ju thanë se ku i mbanin në Zllash?
Pë. Po.
Py. Çfarë ju thanë nëse të kujtohet për vendndodhjen ku kishin qenë?
Pë. Po, më kujtohet.
Py. A mund të na i thuash se çfarë ju thanë për vendndodhjen, nëse të kujtohet përshkrimi i vendit, ndonjë detaj. Nëse nuk të kujtohet, s'ka problem.
Pë. Po. Ata thanë se neve të gjithëve na kanë liruar nga burgu por *[REDAKTUAR]* nuk e kanë liruar. Na kanë mbajtur nën një stallë të kafshëve, podrum ose na i thojna ahër.
Py. E kuptoj. Në çfarë gjendje ishin këta? Çfarë pamje kishin këta njerëzit?
Pë. Të tmerrshme. Të rraskapitur, shenja fytyrës, kështu.
Py. Çfarë shenjash kishin këta personat?
Pë. Nga rrahjet ose maltratimet.
Py. Ti the ishin në "gjendje të tmerrshme" në rreshtin 25. A

mund të na i shtjellosh pak më shumë këtë pamjen e tyre çfarë kishin lëndime apo shenja?

Pë. Po shenja të fytyrës, trupit dhe të lodhur jo të ushqyer mirë.

Py. Po teshat si i kishin? Çfarë pamje kishin ato teshat e tyre?

Pë. Të palara. Të papastërta.

Py. A të kujtohet ndonjë shenjë, a kishin ndonjë lëndim në trup a në duar? A të kujtohet ndonjë gjë përveçse këtyre që na the ndonjë gjë tjetër që kishin në trup a në fytyrë?

Pë. Jo.

Py. I ndihmuat ju ata në ndonjë mënyrë?

Pë. Pse po du me shtu diçka, të lutna, se s'e kam përmend. Se na i kena pyetur, arsyeja pse nuk u liru *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Ata na u kanë drejtu se nuk e kanë liru se i ka këmbë e duar të thyera.

Py. E kuptoj. A i ndihmuat ju këta personat që erdhën aty tek ju?

Pë. Po.

Py. Çfarë bëtë, *[REDAKTUAR]*, për ta?

Pë. Së bashku *[REDAKTUAR]* ju kena dhënë ushqim. Kanë hangër drekë *[REDAKTUAR]* me neve. Disa kanë vazhdu kurse një nga ata nëse s'gaboj prapë emrin *[REDAKTUAR]* ka nejtë dy netë a tri ose katër netë me neve *[REDAKTUAR]*.

Të nesërmen, na ka rrokë ofensiva serbe. Kena shku te

*[REDAKTUAR]* në Prishtinë. Kena qenë aty [në] një podrum.

Py. A mund të na tregosh se çfarë ndodhi më pas, pas këtyre ngjarjeve?

Pë. Po. Ne atë ditë kur kena shku në Prishtinë, unë e kam bujt një natë në Prishtinë *[REDAKTUAR]*. Të nesërmen jam kthyer prapë në fshatin tonë, në *[REDAKTUAR]*. Kam qëndru me *[REDAKTUAR]* dhe disa fshatarë.

Py. A mund të na thuash se kur e mësove atë që i kish ndodhur *[REDAKTUAR]*

Pë. Po kaloj, unë pas një kohe, pas një kohe shtabi UÇK-së, Brigada 153 kanë ardhur në fshatin tonë në *[REDAKTUAR]* në mëhallën tonë, në shpinë e *[REDAKTUAR]*. Në atë kohë ka qenë *[REDAKTUAR]*. Unë me *[REDAKTUAR]* jena shku personalisht që jena taku me *[REDAKTUAR]*. E kena pyetur "A je në dijeni që *[REDAKTUAR]* e ka arrestuar *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* na u ka përgjigj me fjalën "Më falni, nuk di kurrgjë për këtë punë. Pyeteni *[REDAKTUAR]*. Unë nuk jam i informuar absolutisht për këtë punë".

Py. E kishe njohur më parë *[REDAKTUAR]*? E dije kush ishin këta?

Pë. *[REDAKTUAR]* nuk e kam njoftur kurrë. Thojnë se ka ardhë dikun nga *[REDAKTUAR]* E *[REDAKTUAR]* ka mundësi e kam pa një herë a dy se është i anë s tonë, i fshatit *[REDAKTUAR]*. Edhe sot e njoh.

Py. Kur e mësove ti emrin e *[REDAKTUAR]* dhe rolin që kishte?

A u prezantua në këtë rast që e takove me ty?

Pë. Po, u prezantua.

Py. A të tha se çfarë roli kishte?

Pë. Na u përgjigj "Unë jam *[REDAKTUAR]* i Brigadës 153 Zllash".

Py. Kur e takove *[REDAKTUAR]*, në atë rast, e kishe njohur më përpara asaj dite apo jo? Si ja mësove emrin?

Pë. Nuk më kujtohet saktësisht. Ka mundësi që e kam pa një herë a dy më herët. Nuk më kujtohet një herë a dy.

Py. Të kujtohet nëse edhe ai u prezantua në atë rast që u takuat?

Pë. Po, u prezantua.

Py. Në rregull. Pra, me sa kuptoj, as në këtë rast nuk mësove se ç'i kishte ndodhur *[REDAKTUAR]* Atëherë kur e mësove ti më pas atë që i kish ndodhë *[REDAKTUAR]*?

Pë. Po, mbas ofensivës, nëse nuk gaboj, mbas bombardimeve të NATO-s, unë me *[REDAKTUAR]* kena shku në fshatin Zllash.

Py. Po pse shkuat prapë në Zllash?

Pë. Për ta kërkuar *[REDAKTUAR]*.

Py. Pse menduat që do ishte aty?

Pë. Për shkak se të burgosurit që janë liruar, na kanë thënë përveç *[REDAKTUAR]* asnjë s'u mbejtë aty. Veç *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Py. A u gjet ndonjë herë trupi *[REDAKTUAR]*?

Pë. Po, u gjet.

Py. Ku u gjet?
Pë. Në një varr.
Py. Ku ishe ky varri?
Pë. Dikund 200-300 metra më poshtë se burgu i Zllashit.
Py. Pra, në Zllash ishte?
Pë. Po.
Py. Kush e gjeti?
Pë. *[REDAKTUAR]*
Py. Vetë e gjeti apo ishte me dikën tjetër kur e gjeti?
Pë. Jo, në atë ditë ka qenë vetë.
Py. E di ti si e gjeti varrin *[REDAKTUAR]*
Pë. Po dal unë e prej pyetjes. Se kur kena qenë një herë ma herët *[REDAKTUAR]*, para se me e gjetur *[REDAKTUAR]*, në ahër ku i kanë mbajtur të burgosurit e kena gjetë letërnjoftimin e *[REDAKTUAR]*, një jakne *[REDAKTUAR]*. Në atë ahër ka pasë disa infuziona që i kanë marrë të burgosurit në atë shtab.
Py. Pra, ti po thua, që ti bashkë *[REDAKTUAR]* shkuat te ahri ku ishte mbajtur i burgosur *[REDAKTUAR]*
Pë. Po.
Py. A të kujtohet se kur ka ndodhur kjo? Për shembull, në krahasim me kohën kur u gjet varri në ç'kohë ka ndodhë kjo, pra, kur ti dhe *[REDAKTUAR]* shkuat në ahër?
Pë. Ka mundësi dikun një javë, dhjetë ditë para gjetjes së varrit.

Py. Dhe më vonë the që -- pak më përpara the që e gjeti *[REDAKTUAR]* vetë varrin, a të tregoi ndonjëherë *[REDAKTUAR]* sesi e kishte gjetur varrin?
Pë. Po.
Py. Çfarë të tha?
Pë. *[REDAKTUAR]* ka shkuar disa ditë me radhë prej mëngjesit deri në mbrëmje nëpër fshatin Zllash, *[REDAKTUAR]* nëpër mal duke e kërkuar.
Py. A ta ka shpjeguar ndonjëherë sesi e gjeti varrin? Nëse të kujtohet. Nëse ta ka shpjeguar dhe në se ty të të kujtohet. Ndryshe s'ka problem.
Pë. Po, më kujtohet.
Py. Na thuaj se çfarë të kujtohet?
Pë. Më kujtohet kur *[REDAKTUAR]* u zgjua në mëngjes, nëse nuk e gaboj datën pesë apo gjashtë korrik. Mendoj se gjashtë korrik ka qenë. Më ka treguar, më ka thënë "Çohu *[REDAKTUAR]* se e gjeta *[REDAKTUAR]*". "Ku *[REDAKTUAR]*". Ka mundësi që i ka tregu ndoshta dikush ku është varri por ai për mos me na thënë neve *[REDAKTUAR]* me na bë marak ose me na rreziku apo diçka ka thënë "E kam pa në ëndërr". Kupton.
Py. Ti the që mbase dhe dikush i kishte thënë se ku ndodhej varri, e the në rreshtin 12? Ti e more me mend këtë nga sjellja e tij apo ta tha *[REDAKTUAR]* këtë?
Pë. Jo, veç e kam marrë me mend se nuk ma ka thënë.
Py. Dakord, në rregull. Pra, nuk e mësove sesi *[REDAKTUAR]*

arriti ta gjente varrin e *[REDAKTUAR]*; kështu?
Pë. Veç qysh na ka thënë *[REDAKTUAR]* se gjoja e ka pa në ëndërr.
Py. Pra, atë mëngjes, *[REDAKTUAR]* tha se e dinte se ku ndodhej varri. Çfarë ndodhi pastaj? Çfarë bëtë ju më pas?
Pë. Po. Kena shkuar po në atë vend ku na ka *[REDAKTUAR]*, e kena nxjerrë të ndjerin e kena gjete në varr vetë i dyti, më 6 korrik 1999. Nëse s'e gaboj datën, më fal.
Py. Shkove edhe ti vetë tek ai vendi ku ndodhej varri i *[REDAKTUAR]* atje bashkë me *[REDAKTUAR]*
Pë. Po.
Py. A ishte njeri tjetër me ty dhe *[REDAKTUAR]*?
Pë. Në atë ditë jo.
Py. Na thuaj se çfarë ndodhi atë ditën që shkove ti me *[REDAKTUAR]* tek vendndodhja e varrit?
Pë. Ne atë ditë kena shku *[REDAKTUAR]* dhe e kena rrëmih q'atë varrin aty. E kena pa që është *[REDAKTUAR]*. Vetë i dyti në varr. Ne atë ditë e kena lanë prapë në varr.
Py. A mund të na e shpjegosh, të na e përshkruash sesi e morët vesh që ishte *[REDAKTUAR]*
Pë. Në teshat që i ka pasë vesh, po personalisht e ka pasë *[REDAKTUAR]*. Ma së shumti e kena njohë në *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*
Py. Sa shumë rrëmihët për të nxjerrë, për të parë që ishte trupi?
Pë. Jo, aty s'ka qenë 20-30 centimetra s'ka qenë ma poshtë.

Py. Po juve kur e rrëmihët e nxorët të gjithë trupin jashtë?
Pë. Po.
Py. Çfarë pjese të trupit nxorët, zbuluat?
Pë. Komplet *[REDAKTUAR]* e kena nxjerrë. E kena pa dhe një kufomë ka qenë ndër *[REDAKTUAR]*.
Py. Dhe ti the se e *[REDAKTUAR]*. Po ai trupi tjetër ishte i një personi që e keni njohur? E dalluat kush ishte ai tjetri?
Pë. Jo, nuk e kemi njoftë.
Py. E nxorët edhe trupin tjetër?
Pë. Jo, nuk e kena nxjerrë. E kena lanë q'aty. Edhe *[REDAKTUAR]* edhe atë.
 Të nesërmen, kena shku me *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* ka shku herët në mëngjes dhe ka lajmëru, në atë kohë ka qenë organizatë në Kosovë OSBE-ja. I kena lajmëru OSBE-në edhe KFOR-in në atë kohë. Nuk më kujtohet a ka qenë KFOR-i a OSBE-ja. Edhe na i kanë çu veç një person me fotografue në atë kohë. Më 6 korrik nëse s'gaboj jena shku e kena marrë të ndjerin, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* ka vdekur. Nëse s'gaboj a kanë edhe *[REDAKTUAR]*, i ndjeri ka vdek. E kena zhvarros. Kurse trupin tjetër e kena lajmëru KFOR-in që është edhe një viktimë në varr.
Py. Faleminderit. Do t'i trajtojmë detajet e ditës së dytë. Por kam edhe disa pyetje lidhur me herën e parë që shkuat te

varri dhe që gjetët kufomën, *[REDAKTUAR]* dhe të atij tjetrit.

Ti the që nuk e njohe atë trupin tjetër. A patë ndonjë gjë tek ky trupi tjetër? Tiparet e fytyrës apo teshat? A të kujtohet ndonjë gjë?

Pë. Jo. Dhe nuk më kujtohet.

Py. Në rregull, s'ka problem. Përpara se të largoheshit nga varri herën e parë, çfarë bëtë pastaj?

Pë. I kena mbulu prapë të dy në varr. Ditën e parë.

Py. E latë varrin ashtu si e gjetët, pra, e mbuluat përsëri me dhé?

Pë. Po.

Py. Faleminderit, zoti dëshmitar. Më duket se është koha e pushimit dhe do të vazhdojmë më pas.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj që do të ishte një çast i mirë që ta ndërpresim. Është pak përpara orës 11.00, por është kohë e përshtatshme për ta bërë pushimin.

Mund të vazhdojmë në seancë të hapur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Sekretare, a mund të kalojmë në seancë publike, të lutem.

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Faleminderit. Zonja Sekretare, shoqëroje dëshmitarin të dali nga salla e gjyqit.

Zoti dëshmitar, tani do të bëjmë një pushim prej 30 minuta. Do shihemi përsëri në orën 11.30. Faleminderit.

DËSHMITARI: [E padëgjueshme]

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani kam një kërkesë për Mbrojtësen e Viktimave. Do ta bëj në publik. Pastaj do të futemi në seancë private për një çështje dhe pastaj përsëri do të kthehemi në seancë të hapur.

Mbrojtëse e Viktimave edhe ju mund të përgjigjeni në bazë për kërkesën e rregullit 153, afati juaj është 1 dhjetori, pra, javës tjetër. Pyetja që kemi për ju është: Doni dhe ju të keni më shumë kohë në dispozicion, duke pasë parasysh se kemi seancë çdo ditë, gjithë javë? E keni ju në dorë të përgjigjeni.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit për konsideratën. Ne besoj që nuk kemi problem. Do t’i dorëzojmë konstatimet tona në 1 dhjetor.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Kisha parasysh 1 dhjetorin. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sekretare, të kalojmë në seancë private, ju lutem.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më kanë informuar se *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Pyetja që kam për Mbrojtjen është: A mund të na i jepni materialet që Mbrojtja synon t'i bëjë pyetje dëshmitarit *[REDAKTUAR]*

Z. VON BONE: [Përkthim] Do të përfshijmë dy numra ERN që mungonin në atë dokument.

Do ta bëjmë tani, mbas pak.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, Mbrojtës.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Sekretar, të kalojmë përsëri në seancë publike.

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do tA ndërpresim tani punën dhe do të rifillojmë pas 30 minutash.

--- Pauza fillon në orën 11.01

--- Seanca rifillon në orën 11.31

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

se u kthyet. Atëherë për sa i takon pranisë, për ZPS mendoj se shohim të njëjtët persona që ishin në seancën e parë.

E njëjta vlen edhe për Avokaten e Viktimave.

Dhe besoj edhe për mbrojtjen.

Z. VON BONE: [Përkthim] Z. Pelaj do të bashkohet me ne pak më pas.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull atëherë. Z. Mustafa është i lidhur me ne përmes video lidhjes.

Përpara se sa të marrim dëshmitarin në seancë, dua që të jap një urdhër gojor lidhur me kërkesën e mbrojtjes për zgjatjen e afatit kohor për përgjigjen lidhur me parashtrimin e protokolluar F0263. Trupi Gjykues vëren parashtrimin e mbrojtjes që kërkon shtrirjen deri më datë 3 dhjetor 2021 për t'u përgjigjur lidhur me kërkesën e rregullës përkatëse deri më 19 nëntor 2021 dhe shtyrjen në javën pasuese më 22 deri më 26 nëntor 2021.

Në pajtim me rregullin 76 të rregullave, afatet kohore për çdo përgjigje normalisht do të jenë deri më datë 1 dhjetor 2021. Trupi Gjykues mendon se është shfaqur shkak i bazuar brenda kuptimit të rregullit 9, paragrafi 5 dhe do të bëhet një shtojcë e kërkesës së ZPS-së, gjë e cila kërkon shqyrtim për qëllimet e përgjigjes së mbrojtjes. Trupi Gjykues jep leje në mënyrë që mund të shtyhet afati kohor për parashtrimin e F0269 [sipas përkthimit] deri më datë 3 dhjetor 2021.

Ky është fundi i urdhrit gojor.

Znj. Sekretare, a mund të shoqëroni dëshmitarin në sallën e gjyqit, ju lutem.

Znj. Prokurore ju lutem.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, përpara se sa të sillet dëshmitari, do doja të thoja që do të përfundojmë me marrjen e drejtpërdrejtë në pyetje për Dëshmitarin, brenda kësaj seance.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull, faleminderit.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se u kthyet z. dëshmitar.

DËSHMITARI: Faleminderit. Mirë se ju gjej.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë, do t'i jap edhe një herë sërish fjalën Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm që të vazhdojë me marrjen në pyetje.

Fjala për juve Prokurore.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës.

Përderisa pyetja e radhës lidhet me identifikimin e hollësive ose hollësi identifikuese, do t'ju kërkoja Trupit Gjykues të kalonim në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

Sekretare ju lutem, a mund të kalojmë në seancë private.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATES: [Përkthim] Jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Mund të vijoni znj. Prokurore.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

Py. Z. dëshmitar, përfunduam gjatë pushimit duke përshkruar herën e parë kur ju shkuat me *[REDAKTUAR]*, në vendin ku gjendej varri *[REDAKTUAR]*. Ti the që kishte edhe një person -- edhe një vend të dytë -- edhe një rast të dytë kur shkuat në këtë vend, në vendin e varrimit. Tani do t'ju pyes lidhur me këtë.

Përpara se t'ju pyes, a mund të na përshkruani ju lutem, se si ishte zona përreth varrit? Na e përshkruaj pak zonën rreth varrit, të lutem.

Pë. Ka qenë njëra pjesë livadh, njëra mal. Dikun rreth, s'po them 400 metra, rreth 300 metra larg burgut.

PY. Ti the që burgu ishte një ahër, kështu e the?

Pë. Po.

PY. Në rregull. Pra thatë që herën e dytë shkuat, po kësaj radhe shkuat me më shumë njerëz. A mund të na thuash në qoftë se mbani mend se kush tjetër ishte me ju herën e dytë kur shkuat në vendin ku gjendej varri i *[REDAKTUAR]*

Pë. Po. *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. dëshmitar, ju thatë -- përkthyesi tha që nuk e kapi emrin, nuk e kapi emrin e personit që thatë për *[REDAKTUAR]*. A e përsërit edhe një herë të lutem se si e kishte emrin *[REDAKTUAR]*?

DËSHMITARI: *[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit z. dëshmitar.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

PY. A e mbani mend se si shkuat tek vendi ku gjendej varri, d.m.th. me çfarë mënyre transporti, si shkuat?
Pë. Kena shkuar me traktor.
PY. Kur thua "kena shkuar", e ke fjalën për veten edhe për *[REDAKTUAR]* që përmende më sipër?
Pë. Po.
PY. Z. dëshmitar, tani do t'i kërkoj Trupit Gjykues që të kalojmë në seancë të hapur për disa pyetje të cilat kanë të bëjnë me faktin se si shkoi zhvarrimi, çfarë patë, e të tjera. Ju lutem mbani mend të mos përmendi *[REDAKTUAR]* apo *[REDAKTUAR]* Thjesht përgjigjuni pyetjeve që do t'ju bëj unë. Në çdo rast, mos u shqetësoni gjithsesi sepse në qoftë se do t'ju kalojë, do t'ju shpëtojë diçka, ne kemi mënyrat për të bërë korrigjimet e nevojshme dhe për të

bërë redaktimet nga proces verbali publik. A e kuptuat, në rregull?
Pë. Në rregull.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. Prokurore. Dua të shtoj se për momentin nuk ka askënd, nuk është askush te galeria publike, d.m.th. tek publiku nuk ka asnjë të pranishëm këtu në sallën e gjyqit.
Tani z. Sekretar, a mund të na kaloni në seancë publike ju lutem?
[Seance e hapur]
SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike, të nderuar.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Sekretar.
Znj. Prokurore vazhdoni më tej.
ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës.
PY. Z. Dëshmitar, çfarë keni bërë herën e dytë kur ti së bashku me personat e tjerë shkuat në vendin ku ishte varrosur viktima?
Pë. E kena zhvarros viktimën. E kena identiku që ashtë *[REDAKTUAR]* kena pa që i ka pas kamet e thyme, durt e thyme dhe nuk më kujtohet a i ka pas 3 pluma mrapa, a katër.
PY. A e mban mend në qoftë se trupi ishte i mbuluar me ndonjë gjë, apo jo?

Pë. Po.
PY. Me çfarë ishte i mbuluar?
Pë. Me teshat që i ka pas veshë edhe me një qebe.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Prokurore, dëshiroj që për një moment të kalojmë në seancë private.

Z. Sekretar, të lutem a mund të na kalosh në seancë private?

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit z. Sekretar.

Z. dëshmitar, do t'ju kërkoja që të mos përmendnit *[REDAKTUAR]*, d.m.th. të mos thuash *[REDAKTUAR]* Do ishte më mirë që të mos e thoni kështu. Nuk është se ka problem sepse e hoqëm këtë çfarë sapo u tha, por do ishte mirë që të thoni vetëm "personi".

DËSHMITARI: Më fal.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk ka gjë për të kërkuar ndjesë, është e komplikuar për të gjithë ne dhe ne bëjmë më të mirën e mundshme.

Znj. Prokurore shikoj që jeni ngritur në këmbë.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, thjesht për të thënë që nuk e thashë, nuk e përmenda, por do kërkojmë redaktimin e kësaj

që sapo tha dëshmitari. Ju sapo e përmendët, por gjithsesi do të përpiqemi që të vazhdojmë, në të kundërt do kthehemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Arsyeja që kaluam në seancë private, besoj që është e qartë.

Z. Sekretar, ju lutem a mund të na kaloni përsëri në seancë publike tani?

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem vazhdoni znj. Prokurore.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës.

PY. Z. dëshmitar, ti the se ti dhe të tjerët e zhvarrosët trupin, që trupi ishte i mbështjellë me një batanije. A mund të përshkruash se çfarë patë tjetër në trupin?

Pë. Kur e kena çel prej batanijes, qebes, kena vrejt që i ka këmbët e thyme, duart e thyme dhe 3-4 pluma mrapa shpinës.

PY. A na thua dot ju lutem, se si e vutë re ju që i kishte duart dhe këmbët e thyme?

Pë. Po u dukshin, u dukshin të thyme në lëvizje. Kur e kena kap, u dukshin këmbët dhe duart që i ka të thyme.

PY. A përshkruani dot shenja të tjera që ju patë në trup?

Pë. Edhe plumat mbrapa shpinës. I kena pa birat që i ka pas pluma.

PY. A vutë re ndonjë shenjë tjetër?
Pë. Jo.
PY. Çfarë bëtë me trupin, ju thatë që e zhvarrosët. Të lutem, a e na përshkruan pak sipas hapave të ndryshme që ndoqët se çfarë keni bërë? Dhe të lutem mbaj mend që jemi në seancë të hapur.
Pë. Po, e kena marrë trupin, e kena zhvarros, e kena shti në arkivol.
PY. Si e latë varrin, atë zonën ku ishte varri, si e latë kur u larguat pasi e morët trupin me vete?
Pë. Ka mbet një kufomë aty. Një viktimë tjetër ka mbet, e kena mbulu atë viktimën edhe kena lajmëru OSBE-në, KFOR-in.
PY. Pra, ju po thoni se nuk është se e zhvarrosët atë trupin tjetër, apo jo?
Pë. Jo.
PY. Po dheun e varrit, d.m.th. varrin e mbuluat njësoj siç e gjetët kur shkuat aty?
Pë. Po.
PY. Herën e dytë kur shkuat, a patë ndonjë hollësi, ndonjë gjë tjetër lidhur me trupin e dytë që ishte në të njëjtin varr?
Pë. Jo.
PY. Pra, e kuptoj që trupi tjetër nuk ishte fare i mbuluar, asnjë pjesë e tij nuk ishte e mbuluar, trupi tjetër?
Pë. Jo, ka qenë me batanije.

PY. Ju thatë që ishte i mbuluar me batanije...
Pë. Po.
PY. ...a ishte e njëjta batanije me të cilën ishte mbuluar edhe trupi i parë?
Pë. Jo. Një batanije ai, një ai.
PY. A mund të na thuash në qoftë se ishte trupi i një femre apo mashkulli?
Pë. Nuk më kujtohet.
PY. Në rregull.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të kalojmë në seancë private, sepse pyetjet e radhës do të nënkuptojnë hollësi identifikuese.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Sekretar, mund të na kaloni në seancë private ju lutem?

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit z. Sekretar.

Znj. Prokurore vazhdoni më tej ju lutem.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës.

Py. Z. dëshmitar, ti the në rreshtin 19 dhe 20 të transkriptit të ditës së sotme që, ju informuat OSBE-në ose KFOR-in.

Pyetja që kam për juve është kjo, kush e bëri këtë gjë, kush e njoftoi OSBE-në ose KFOR-in?

Pë. *[REDAKTUAR]*

PY. Mirë, faleminderit. Ti the që trupi u vendos në një arkivol. Ku u dërgua, ose ku u varros *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Pë. E kena varros në *[REDAKTUAR]*, në *[REDAKTUAR]* në *[REDAKTUAR]*

PY. Në shtëpinë e familjes në *[REDAKTUAR]*?

Pë. Në varrezat e familjes në *[REDAKTUAR]*.

PY. Në rregull. Trupi, a është larguar, është hequr ndonjëherë nga kjo *[REDAKTUAR]* në *[REDAKTUAR]*?

Pë. Jo.

PY. A është zhvarrosur ndonjëherë apo është bërë ndonjë analizim mjeko-ligjor nga ndonjë agjenci ndërkombëtare si për shembull OSBE-ja, KFOR-i, UNMIK-u, me aq sa dini ju?

Pë. Jo. Nuk është bërë.

PY. Z. dëshmitar, tani do t'ju tregoj tri dokumente, apo tri dokumente certifikata vdekje që ke marrë dhe i ke sjellë me vete në intervistat që ke bërë me Zyrën e Prokurorisë së Specializuar.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund t'i kërkoj z. Sekretar që të na shfaqë dokumentin e shënuar me numrin e identifikimit ERN007823 deri në 28, RED [sipas përkthimit]. Është dokumenti i cili është në ndarjen 8 për listën e provave për këtë

dëshmitar. Ju lutem, a mund të shfaqni pak faqen 3 në ekran?
Py. Z. dëshmitar, a mund ta shihni dokumentin që është shfaqur në ekran?
Pë. Po.
PY. A mund të na thuash se çfarë është ky dokument dhe në qoftë se njihni ndonjë shënim të bërë me shkrim në dokument, në pjesën e djathtë në majë të tij?
Pë. Po. Kjo është certifikata e vdekjes *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*
PY. A e njeh shënimin me shkrim në të djathtë në fillim të dokumentit që është afër numrit 077825, që është e shkruar me të kuqe? E njeh këtë nënshkrimin, këtë shënimin me shkrim dore?
Pë. Jo.
PY. A është ky një prej dokumenteve që ke sjellë me vete kur bëre intervistën me ZPS-në?
Pë. Po.
PY. Nënshkrimi, firma këtu në fillim të dokumentit, a është nënshkrimi juaj? Ndoshta nuk e shikoni mjaftueshëm, po të doni mund ta zmadhojnë pak. Pra është...
Pë. Po, e shikoj.
PY. ...ky shënimi që është nën 077825. A e njihni?
Pë. Po. Ky nënshkrimi këtu ashtë i jemi.
ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund të kalojmë në faqen tjetër, ju lutem.

PY. Kjo është një tjetër certifikatë vdekje, apo jo. E saktë?
Pë. Po, e saktë. E *[REDAKTUAR]* është kjo.
ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund të kalojmë tek faqja tjetër, ju lutem?
PY. Çfarë mund të na thuash lidhur me këtë certifikatën? Me këtë certifikatën tjetër?
Pë. Kjo ashtë certifikata e vdekjes *[REDAKTUAR]*.
PY. A mund të na thuash se nga është marrë kjo certifikatë?
Pë. Nga zyra e vendit në *[REDAKTUAR]*.
PY. A mund të konfirmoni që, këto tri certifikatat që ne pamë janë kopje të dokumenteve origjinale që ke sjellë me vete gjatë intervistës me Zyrën e Prokurorisë së Specializuar?
Pë. Po.
PY. Z. dëshmitar, tani do të kalojmë në grupin e fundit të pyetjeve, të cilat kanë të bëjnë me marrjen në pyetje ditën e sotme.
Pas zhvarrosjes dhe pas varrosjes së trupit të *[REDAKTUAR]*, a kishit ndonjë frikë ndonjë shqetësim lidhur me atë çfarë i kishte ndodhur atij, pra çfarë i kishte ndodhur *[REDAKTUAR]*?
Pë. Po, kena frikë. Edhe sot kena atë frikë.
PY. A mund të na e shpjegosh pak më shumë?
Pë. Po. Gjithë kena jetu edhe sot jetojmë me frikë, me stres. Nuk di sa ma shumë -- s'un e përshkruaj frikën.
PY. Çfarë pasoje apo çfarë ndikimi ka pasur vdekja

*[REDAKTUAR]* mbi ty edhe *[REDAKTUAR]*, për muajt dhe vitet më pas?

Pë. Pasojat janë shumë të tmerrshme, janë pasojat. Shumë të mëdhaja kena pasoja. Nuk jena të lirë as në punë me shku, as në qytet me shku, nuk jena të lirë.

PY. Dhe lidhur me mënyrën se si kjo ka pasur ndikim personalisht mbi ty?

Pë. Mbi mu ka shumë ndikim. Jetoj veç me stres edhe me tut.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do konsultohem pak me kolegët e mi, për të ditur nëse kemi ndonjë gjë tjetër që duam ta mbulojmë me Dëshmitarin.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Merrni kohën që ju nevojitet.

[Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen midis tyre]

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam pyetje të tjera, kështu që mund të kthehemi në seancë të hapur. Dhe kaq kisha unë për sa na takon pyetjeve tona.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sekretar, të kalojmë në seancë publike, të lutem.

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Prokurore keni fjalën.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Z. dëshmitar, kaq ishin pyetjet e mia. Nuk kam pyetje të tjera për të bërë.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. Prokurore.

Për arsye organizimi do ta ndryshojmë pak programin, që do të thotë që tani do të bëjmë një pushim dreke deri në 1.30, apo më mirë të them deri në 1.45. Pastaj do të vazhdojmë me pyetjet që do të bëj Mbrojtësja e Viktimave dhe pastaj Mbrojtja.

Sekretar, nxirreni pak dëshmitarin.

Z. Dëshmitar, tani do të bëjmë një pushim për drekë deri në orën 1.45.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani do të ndërpresim punën dhe do -- ah, më fal. Prit se do flasi Mbrojtësi. Avokati i Mbrojtjes keni fjalën.

Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë. Do të parapëlqenim që të fillonim pyetjet për këtë dëshmitar sot, sepse nuk kemi kohë të përgatitemi. Nesër, pra.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit Avokati i Mbrojtjes.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Atëherë pyetja që kam tani është për Mbrojtësen e Viktimave. Çmendoni ju lidhur me pyetjet që doni të bëni sot?

ZNJ. PUES: [Përkthim] Unë do të isha e gatshme të bëja pyetjet e mija ose pas një pushimi të shkurtër tani, ose mbas pushimit të drekës. Nuk besoj se do të më duhet më shumë se gjysmë ore, pak a shumë. Mbase edhe më pak. Duke qenë se disa nga çështjet u mbuluan nga Prokuroria.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë, -- oh, znj. Prokurore po, mund të vazhdoni.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Lidhur me kërkesën e Avokatit Mbrojtës pa treguar ndonjë shkak të fortë, ne do të parapëlqenim të vazhdonim sot, apo të paktën të fillonin pyetjet e Mbrojtjes sot.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Avokatja e Viktimave.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Ka një -- jemi në seancë të hapur apo?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jemi në seancë të hapur.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Në këtë rast, a mund t'ju kërkoj të kalojmë në seancë private për një çast ju lutem?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Na kaloni në seancë private ju lutem.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni Mbrojtësja e Viktimave.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit shumë.

Doja të shtoja se nga këndvështrimi i të dy dëshmitarëve që do dëshmojnë këtë javë, të dy mezi presin të kthehen sa më shpejt që të munden, sepse duhet *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*, gjë që të dy janë mjaft të shqetësuar. Kështu që për të mirën e të dy dëshmitarëve, që besoj se *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*, do të ishte e mirë që pyetjet të ishin sa më të shkurtra që të jetë e mundur brenda kohës. Prandaj nëse kemi mundësi që të përfundojmë brenda një dite, apo një dite e gjysmë, do të ishte shumë mirë për mirëqenien e tyre. Diçka që mendoj se ka shumë rëndësi të merret parasysh.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Avokati i Mbrojtjes, keni dëshirë të parashtroni diçka tjetër?

Z. VON BONE: [Përkthim] Po qe se mbarojmë nesër në mëngjes, besoj që do mbarojmë atëherë. Kështu që besoj që 12 e gjysmë apo kështu do të përfundojmë me pyetjet tona. Nuk besoj se do të prishte ndonjë punë. Thjesht që të kemi pak më shumë kohë për t’u përgatitur lidhur me disa nga çështjet që do të -- për të cilat do të bëjmë pyetje. Nuk jam i sigurt por mbase do të përfundojmë nesër me këtë Dëshmitar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë, faleminderit Avokat i Mbrojtjes.

Znj. Prokurore, ju lutem.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Është në lidhje me listën e dokumenteve për të cilët ju kemi njoftuar. Këtë mund ta bëjmë përpara se Mbrojtja të fillojë të bëjë pyetjet, por kishim disa gjëra për të thënë lidhur me dokumentet e renditura dhe mënyrën se si Avokati i Mbrojtjes ka ndërmend t'i bëj parashtrimet e tij. Dhe mbase këtë mund ta diskutojmë përpara se ata të fillojnë pyetjet e tyre.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të ishte ide e mirë, mendoj, nëse Prokuroria në këtë çast, do të na bënte të njohura konstatimet e veta që t'i marrim parasysh.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Sigurisht, jemi në seancë private kështu që po vazhdoj në seancë private për shkak të natyrës së atyre që do them.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për të qenë të ndershëm, një pjesë e diskutimeve mund të ishin publike, e kuptova, por nuk desha të ndërprisja diskutimin. Tani jemi në seancë private kështu që mund të vazhdoni.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

Ajo që do të them ka lidhje me faktin që, lista e dokumenteve për kundër-pyetje që do t'i bëhen dëshmitarit, liston një numër transkriptesh dhe deklaratash të dëshmitarit të mbrojtur përpara Gjykatës. Pra, po të lë mënjanë peshën që

mund të ketë një ushtrim i tillë, që është diçka që sigurisht ua lemë ju në dorë si Trup Gjykues, ne do të presim nga Avokati Mbrojtjes që pyetjet t'i bënte në mënyrë të përgjithshme, me qëllim që këto pyetje të mos identifikojnë njerëz të caktuar si dëshmitarë përpara kësaj Gjykate.

Meqenëse nuk është e qartë për ZPS-në mënyra se si transkripti dhe deklaratat e Dëshmitarëve të mbrojtur në këtë çështje mund të përdoren, shkallën deri ku, kjo është thelbësore për t'ia bërë një dëshmitari tjetër, ne deshëm t'i ngrinim këto çështje që të jetë e qartë se si, apo të jenë të qartë kufijtë deri ku kjo gjë mund të bëhet. Dhe, e thashë prapë, po të lemë mënjanë çështjen e peshës së një ushtrimi të tillë. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. Prokurore. Ju ngritët një çështje që edhe ne si Trup Gjykues do ta kishim ngritur për ta diskutuar, kështu që faleminderit.

Avokatja e Viktimave, doni të thoni diçka për këtë pikë?

ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokati i Mbrojtjes, dëshironi të shpreheni lidhur me këtë çështje?

Znj. Prokurore jeni ngritur përsëri në këmbë.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Më fal, por duhet të kisha shtuar gjithashtu lidhur me shpjegimet se përse kundër-pyetjet

duhet të fillojnë nesër, që ne nuk kemi dëgjuar akoma që të tregohet një arsye e fortë për këtë, arsye e vlefshme. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokat i Mbrojtjes, pyetja që shtrohet është kjo, nëse edhe pse ju dhatë një shpjegim se përse doni t'i bëni nesër pyetjet tuaja, por nëse mund të shtoni diçka, nëse keni diçka për të shtuar, ju lutem bëjeni tani.

Dhe ZPS-ja ka ngritur çështjen se si pyetjet tuaja lidhur me dëshmitë e dëshmitarëve të mbrojtur që kanë dëshmuar ndërkohë përpara Gjykatës dhe do të vazhdojnë. Si ju keni ndërmend të vazhdoni me pyetjet tuaja, duke mbajtur parasysh që nuk duhet t'i identifikojmë këta Dëshmitarë të mbrojtur.

Z. VON BONE: [Përkthim] Lidhur me identifikimin e ndonjë dëshmitari të mbrojtur, sigurisht që nuk do të bëhet -- pyetjet do tu bëhen në seancë private. Kështu do të vazhdojë për sa i takon kësaj çështje.

Për sa i takon dokumenteve...

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një minutë, një minutë.

Për sa i takon identifikimit të ndonjë dëshmitarit, kjo do të bëhet në seancë private, thè.

Puna është që dëshmitarët e mbrojtur në Gjykatë, nuk duhet të dihen emrat e dëshmitarëve të mbrojtur. Pra, kur e bëni pyetje për të komentuar për dëshmitarë të tjerë të

mbrojtur. Është një çështje delikate sepse ndonjëherë nuk mund ta pyesësh "E ke thënë këtë", sepse personi tjetër do ta dinte që është ky apo ai person.

Pra nuk bëhet fjalë vetëm për të shkuar në seancë private, bëhet fjalë për më shumë se aq.

Z. VON BONE: [Përkthim] Për këtë çështje mund të them se, ne me shumë gjasa do të pyesim se kush e ka vizituar shtëpinë e këtij dëshmitari konkret.

Jemi në seancë private?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

Z. VON BONE: [Përkthim] Pra, për sa i takon kësaj, thjeshtë do të përpiqem të provoj me këtë dëshmitar, të vërtetoj nëse ai ka vënë re apo ka konstatuar gjë lidhur me njerëzit që kanë vizituar shtëpinë e këtij dëshmitari. Dhe kjo ka të bëjë me mbërritjen e njerëzve që u liruan, pa i përmendur emrat e tyre.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe pa thënë...

Z. VON BONE: [Përkthim] Dhe pa thënë pseudonimin apo diçka tjetër. Por sigurisht që disa njerëz -- dëshmitari foli për disa prej tyre dhe unë besoj që ishte edhe një person që ai përmendi, që e njihte atë person. Pra thjesht konstatimet e tija në lidhje me këta njerëz, ato duam të sqarojmë për këtë çështje.

Dhe kjo vlen për shumicën e njerëzve që janë listuar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokat i Mbrojtjes, dua që t'ju përgjigjem që të zhvillojmë një diskutim për këtë. Ju nuk duhet të thoni që, "Ky person tha se ishte në vendin tënd" dhe "Mund ta konfirmoni këtë", për shembull. Nuk do të ishte kjo mënyra e duhur për të trajtuar çështjen.

Z. VON BONE: [Përkthim] Përveçse nëse është një person që ai e ka përmendur vetë në një deklaratë të mëparshme. Atëherë është e qartë se ai person mund të ketë qenë i pranishëm apo jo.

Ne e dimë se mund të përmendim, të flasim për dallimin moshor të këtyre njerëzve që kanë ardhur në shtëpinë e tij, përshkrimin e tyre, që në një fazë të mëvonshme të kemi mundësi të shohim se kush mund të ishin këta persona. Me siguri që ai përmendi një person.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pini pak ujë dhe së pari ia jap fjalën Mbrojtjes së Viktimave, e cila u ngrit në këmbë përpara.

Ju lutem.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Kam dy gjëra dhe mbase është mirë që po e diskutojmë tani pyetjet që do të bëj mbrojtja në seancë private, që të shmangim ndonjë ndërprerje të panevojshme gjatë kohës që Mbrojtja të bëj pyetjet e veta.

Ka një gjë të cilën unë dua ta theksoj, duke pas parasysh cënueshmërinë e dëshmitarit dhe të gjithë në dhomë e ndjejnë

trysninë në të cilin ai është. Pra bëni mirë që i kujtoni Mbrojtjes nevojën për të mos përsëritur në mënyrë të panevojshme gjëra. Ne dëgjuam gjerë e gjatë sot në mëngjes atë që ka thënë dëshmitari lidhur me ditën kur ai grupi i njerëzve erdhi në shtëpinë e tij, pasi u liruan nga burgu. Sigurisht është një pyetje që mund të ketë Mbrojtja se kush ishin të pranishëm, me që u përmend një emër nga dëshmitari.

Por, është një gjë që potencialisht të bësh një pyetje, t'i bësh një pyetje dëshmitarit për deklaratën e tij kur e përmendi emrin, nuk e mbaj mend tani përmendësh por përmendi. Por është një gjë tjetër dhe kjo nuk duhet lejuar të thuash që, "Ky person konkret na ka thënë këtu".

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I thashë këto gjëra, Mbrojtëse e Viktimave. E diskutuam dhe është e qartë kjo gjë. Për mua të paktën është e qartë. E thashë shumë hapur.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit. Sepse nga ç'tha mbrojtja, mu duk sikur thjesht fakti që është përmendur një emër, mund të bëj që ai t'i drejtohet transkriptit të atij dëshmitari konkret.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit Mbrojtësja e Viktimave.

Znj. Prokurore.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit të nderuar. Po, kemi dy gjëra. E para ishte pak a shumë njëlloj si ato që

ngriti Avokati i Mbrojtjes [sipas përkthimit]. Nuk ishte e qartë për mua se, ushtrimi që Avokati i Mbrojtjes do të përdorte, nënkuptonte mos përdorimin fare të deklaratës. Kur Avokati i Mbrojtjes tha në rreshtin 16-17 sot, "Përveçse nëse është një person që ai e ka përmendur me emër", që dëshmitari pra, "në deklaratat e tij të mëparshme", më përpara vetë.

Pra të jemi të qartë, se fakti që dëshmitari e ka ditur emrin e një personi dhe e ka përmendur atë emër, kjo megjithatë nuk na e lejon Avokatin e Mbrojtjes te kundër pyetjet e veta, ta pyesë dëshmitarin për deklaratën e dhënë përpara kësaj Gjykate nga ai person, emrin e të cilit Dëshmitari e njeh dhe ta identifikojë atë si dëshmitar, jo vetëm në këtë procedurë, por edhe si dëshmitar që ka dhënë deklarata më parë.

Kjo ishte për sqarim, pak a shumë njëlloj siç tha edhe Avokati i Mbrojtjes [sipas përkthimit].

Pastaj, nuk është ende e qartë për ne si ZPS se çfarë shkalle, deri ku Avokati i Mbrojtjes dëshiron të përdorë transkriptin e dëshmitarëve të tjerë, sepse në qoftë se qëllimi ishte të sqaronte disa aspekte të dëshmisë së Dëshmitarit, atëherë ZPS-ja nuk e shikon nevojën se pse duhet të modifikohet transkripti, më fal, duhet të njoftohet transkripti.

Nuk jemi të qartë se, pse duhet përdorur transkripti apo deklaratat e dëshmitarëve të tjerë. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Prokurore, për mua, a mund të jeni pak më konkrete? Dhe po shikoj, hedh sytë nga Avokati i Mbrojtjes, shpresoj që të pajtoheni me mua, se është e qartë se që, nuk duhet që dëshmitarit t'i bëni pyetje lidhur me informacione nga deklaratat e dëshmitarëve që kanë dëshmuar përpara kësaj Gjykate, apo që ka dhënë deklarata për ZPS-në, që e lejojnë këtë dëshmitar sot të identifikojë se nga vjen ky informacion. Për këtë pajtohemi.

Nuk ka dyshim për këtë. Kështu që kjo pikë është sqaruar. Kjo është një pjesë e deklaratave të cilat janë renditur në listën e mbrojtjes, të cilat ata kanë synim t'i përdorin për kundër-pyetjet e tyre.

Por, ka dhe deklarata të tjera të dëshmitarëve. Deklarata të dëshmitarëve të tjerë në atë listë. E keni fjalën për ato? Në qofte se po, nuk e kuptoj pyetjen tuaj konkretisht.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, e kisha fjalën për deklaratat dhe transkriptet e dëshmitarëve të mbrojtur në këtë çështje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për këtë pikë atëherë, është sqaruar.

Kam akoma një pyetje për Avokatin e Mbrojtjes. Vë re se ju po bëni parashtrime, mbase doni të shtoni diçka tjetër atyre që donit t'i bënit të njohura për ne dhe për të gjithë palët?

Pyetja që kam ende për ju është -- më fal Avokat i Mbrojtjes, më shumë është për ZPS-në. ZPS-ja, a kundërshton përballjen e këtij dëshmitari 4931, me deklaratat e dëshmitarit për ZPS-në me numër *[REDAKTUAR]*? Që të jetë e qartë për dëshmitarin sot, që ne po flasim për ta, sepse *[REDAKTUAR]*...

A ka ndonjë interes të mos nxirret kjo?

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës. Është e qartë se dëshmitari që po dëshmon, e di dëshminë *[REDAKTUAR]* i di dhe deklaratat që ka dhënë *[REDAKTUAR]* edhe pse mund të mos jetë i njohur me hollësitë që përmbajnë ato.

Por përsëri, kjo është një çështje që lidhet me peshën që do t'i jepni këtij ushtrimi. Në fund të fundit jeni ju, është detyra juaj si Trup Gjykues të vlerësoni besueshmërinë, konsistencën, konsekuencën e dëshmitarëve. Pra, puna është që të mos identifikohen dëshmitarët, për këtë po flisnim, për t'u siguruar që të mos dalë që edhe të tjerë kanë dhënë deklarata ZPS-së, edhe nëse nuk po përdoren ende, apo nuk janë përdorur fare.

Por, në lidhje me dy dëshmitarët që ju përmendët, nuk ka problem.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull, mirë atëherë. Shumë mirë.

Dale të shoh, çfarë do të bëjmë tani. Ora është 12 e gjysmë.

Së pari do të kalojmë në seancë publike.

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit shumë.

Tani propozoj që të bëjmë pushim deri në orën 2, pastaj do t'u japim disa udhëzime dhe do të përmbledhim në publik, në seancë publike, qëndrimin tonë lidhur me pyetjet apo lidhur me përdorimin e materialit të propozuar nga Mbrojtja, sepse diskutuam shumë gjëra në seancë private, po ka shumë rendësi gjërat t'i bëjmë të qarta se ku qëndrojnë palët, Avokatja e Mbrojtjes [sipas përkthimit], ne si Trup Gjykues, pra qëndrimet tona përkatëse, të cilat do të paraqiten pra në seancë publike.

Pastaj do t'ia jap fjalën Avokates së Viktimave për të vazhduar me pyetjet e saj.

Dhe pastaj, duke marrë parasysh se pyetjet e ZPS-së zgjatën më pak se ç'ishte parashikuar, është mirë që të fillojmë nesër në 9.30 me pyetjet e Mbrojtjes. E mbajta shënim që ju thatë ato që thatë.

Për sa i takon kohës që do t'i jepet Mbrojtjes, kohëzgjatjes së dëshmisë, edhe kësaj çështje do t'i drejtohem mbasi të mblidhemi pas dreke.

Pra kaq kishte për momentin.

Do të na dërgoni listën e materialeve, - i drejtohet mbrojtjes. Faleminderit.

Kalofshi mirë për drekë dhe shikohemi përsëri në 2.00.

Ndërpritet seanca këtu.

--- Pauza e drekës fillon në orën 12.30

--- Seanca rifillon në orën 14.00

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani do të vazhdojmë me dëgjimin e dëshmisë së dëshmitarit, por në fillim do të shikoj palët. Përbërjen e palëve. Jemi me të njëjtën përbërje dhe për sa i takon Mbrojtjes së Viktimave. Faleminderit.

Z. VON BONE: [Përkthim] Fatmir Pelaj nuk do të vijë. Do të vijë nesër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pjesa tjetër është e njëjtë. Faleminderit për këtë.

Përpara pushimit diskutuam në seancë private çështjen e mënyrës se si palët dhe Mbrojtja e Viktimës duhet t'i bëjë pyetjet -- kur bëhet fjalë që ta pyesin dëshmitarin për informata të dhëna nga dëshmitarët e tjerë në këtë çështje.

Në këtë drejtim ZPS-ja ka parashtruar se kjo duhet bërë në mënyrë të përgjithshme me qëllim që të mos identifikohet dëshmitari. Jo vetëm përkundrejt publikut por edhe njerëzve të tjerë që kanë qenë dëshmitarë përpara Gjykatës.

Tani Trupi Gjykues do të japi disa udhëzime lidhur me

përdorimin e deklaratave apo dëshmive të mëparshme të dy kategorive të ndryshme personash. Dëshmitarët e mbrojtur të ZPS-së, grupi i parë dhe personat e tretë që kanë dhënë dëshmi autoriteteve gjyqësore por që nuk janë dëshmitarë të ZPS-së në këtë çështje. Për sa i përket kategorisë së parë, palët dhe Avokati i Viktimave dhe për Trupin Gjykues vlen, duhet t'i kushtojnë vëmendjen më të madhe mënyrës se si e formulojnë pyetjen dhe si duhet ta pyesin dëshmitarin lidhur me dëshminë e dëshmitarëve të tjerë të mbrojtur të ZPS-së. Kjo është kështu sepse nuk duhet të nxjerrim identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur të ZPS-së, jo vetëm për publikun por edhe për dëshmitarin që dëshmon në Gjykatë në pajtim me masat mbrojtëse të miratuara.

Rrjedhimisht, çdo referim ndaj deklaratave apo dëshmive të mëparshme të dëshmitarëve të mbrojtur nuk duhet -- qoftë në seancë private apo publike -- nuk duhet të identifikojmë. Asnjë përjashtim nuk parashikohet. Megjithatë Trupi Gjykues ka parasysh se për dëshmitaren *[REDAKTUAR]* është situata -- është disi -- *[REDAKTUAR]* -- është e veçantë. Duke qenë se Prokuroria nuk kundërshton, palët dhe Mbrojtja mund ta konfrontojnë drejtpërdrejtë me deklaratën e *[REDAKTUAR]*. Kjo vlen edhe për dëshmitarin *[REDAKTUAR]* të cilin do ta dëgjojmë më vonë gjatë kësaj jave.

Për sa i takon kategorisë së dytë, Trupi Gjykues kujton klimën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve që

mbizotëron në Kosovë, si dhe nevojën për të ruajtur integritetin e hetimeve të ZPS-së. Rrjedhimisht palët dhe Avokati i Viktimave nuk duhet t'i referohen emrave të këtyre personave, as informacioneve identifikuese, qoftë në seancë private, apo publike. Nëse palët apo Avokati i Viktimave dëshirojnë ta pyesin dëshmitarin për dëshmitë që burojnë nga persona të tjerë, që mund të nxjerrin në pah identitetin, duhet të tregojnë, të vënë në dukje arsyet pse duan ta bëjnë dhe Trupi Gjykues vendos pastaj.

Ky është udhëzimi që kemi, që japim sot për këtë çështje.

Tani do të vazhdojmë me pyetjet e dëshmitarit nga Mbrojtësja e Viktimave. Ju na informuat që do t'ju duhet gjysmë ore apo edhe më shumë.

Dhe për sa i takon Avokatit të Mbrojtjes, nesër do të filloni në 9.30 me pyetjet tuaja dhe do të keni një seancë, pra një orë e gjysmë, për të bërë kundër-pyetjet tuaja.

Kaq kemi për tani, dhe tani ju lutem, silleni dëshmitarin në sallën e Gjyqit. Faleminderit.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni ju lutem.

Mirë se jeni kthyer përsëri, zoti dëshmitar.

DËSHMITARI: Mirë se ju gjej. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani do t'ia jap fjalën Mbrojtjes së Viktimave për të bërë pyetjet

e saj.

Zonja Mbrojtëse, keni fjalën.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës dhe mirëdita, zoti dëshmitar.

Py. Pikë së pari faleminderit për dëshminë informative që dhatë sot në mëngjes. Si avokate, që përfaqësoj viktimat pjesëmarrëse, dëshiroj të të bëj disa pyetje të tjera. Por, përpara se t'i bëj pyetjet, kërkoj që të kalojmë në seancë private, ju lutem.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të kalojmë, ju lutem, në seancë private.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Vazhdoni zonja Mbrojtëse e Viktimave

Pyetje nga Mbrojtja e Viktimave:

ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit.

Py. Tani jemi në seancë private, që do të thotë se asgjë nga gjërat që do të dëgjojmë këtu nuk do të dali jashtë kësaj salle, siç ka ndodhur dhe në mëngjes, pra mund të flisni më lirisht dhe mund të përmendni edhe emra.

Ka një çështje për të cilën dua të bëj disa pyetje, pas atyre që thatë sot në mëngjes. Ju na folët për ato ditë kur disa njerëz erdhën në *[REDAKTUAR]* dhe të pyetën nëse të kujtoheshin emrat e tyre dhe ti the jo dhe unë dua të të

kujtoj kujtesën për një gjë konkrete të intervistës që i ke dhënë Zyrës së Prokurorisë për atë ditë konkrete.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Ju lutem të vendosim në ekran intervistën me numër ERN 060723-TR-ET, Pjesa 1, faqja 36, në rreshtin 20 deri te 23 afërsisht. Faleminderit.

Py. Zoti dëshmitar, i shikon të dy versionet e transkriptimit të intervistës, i ke përpara në anglisht dhe në shqip, por unë do të lexoj një pjesë shumë të vogël për të cilën dua të të bëj pyetje.

Kur ke folur për këtë ditë konkrete, kur *[REDAKTUAR]* ata njerëzit nga Zllashi *[REDAKTUAR]*, ty të kanë pyetur për disa emra. Te rreshti 20 të kanë pyetur për emrin e *[REDAKTUAR]* dhe përgjigja jote ka qenë: "Po".

Dhe pyetja tjetër që të kanë bërë është: "Çfarë di për *[REDAKTUAR]*?"

"Ai *[REDAKTUAR]* -- ai *[REDAKTUAR]*, ishte edhe ai në burg".

Të kujtohet që ta kesh thënë këtë -- këto fjalë në intervistën që ke dhënë?

Pë. Po.

Py. Dhe ishte e saktë kjo pra?

Pë. Po edhe sot e njoh *[REDAKTUAR]*.

Py. Faleminderit. Në të njëjtin dokument, por në faqen tjetër dhe ju lutem ta kalojmë te faqja 37, rreshti 6, dhe më poshtë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nga sa kuptoj unë, dokumenti në shqip është përkthimi? Jo.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Nuk jam e sigurt. Nuk kuptoj shqip.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] As unë nuk kuptoj shqip, po nuk është i njëjti tekst.

Shoh që ngrihet Avokati.

Z. SHALA: [Përkthim] Pra nuk është i njëjti version. Faqet nuk janë të njëjta. Në shqip është një faqe tjetër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë më mirë të propozojmë -- propozoj që të përdorim vetëm anglishten. Dhe sigurisht sepse përkthehet në shqip. Do të kemi mundësinë ta dëgjojmë në shqip.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Nuk kam asnjë problem.

Py. Zoti dëshmitar, pra në këtë intervistë që thamë, pak më poshtë, të pyetëm dhe në anglisht është rreshti 6 në faqen 36, të kanë pyetur:

"A kanë përdorur emrin e *[REDAKTUAR]*? E kanë përmendur?"

Dhe përgjigja jote ishte: "Po".

Të pyetën: "Çfarë di për këtë emër?"

Ti ke thënë: "Nuk e mbaj mend, nuk e di".

Tani pyetje: a të kujtohet që emri *[REDAKTUAR]* -- a të kujtohet ky emër apo ta bëj ndryshe pyetjen: a të kujtohet që të kanë pyetur nëse është përmendur emri i *[REDAKTUAR]*?

Pë. Nuk më kujtohet.

Py. Në rregull, faleminderit. Faleminderit për informacionin që na dhe.

Tani të kalojmë te pyetjet që lidhen me ndikimin që ka pasur krimi tek ty dhe *[REDAKTUAR]*. Ti e përmende sot në mëngjes kur të pyeti zonja Prokurore, se ke frikë, tutesh, edhe sot. Dhe kjo ndodhet në faqen 46 të transkriptit, rreshti 14 e poshtë. Ti the gjithashtu që nuk ndihesh i lirë dhe dua që të të bëj disa pyetje të tjera lidhur me këtë dhe mbase ty të krijon emocione, siklet edhe unë e kuptoj shumë mirë këtë gjë, por ka rëndësi që ne ta kuptojmë plotësisht se si kjo të ka prekur ty dhe familjen, si të ka ndikuar.

Së pari do të pyes për veten tënde, ti vetë çfarë ke përjetuar, çfarë stresi ke përjetuar vetë ti, si ky stres të ka ndikuar ty?

Pë. Nuk muj me përshkru sa keq. Vuj shumë, kam stres shumë, s’jam i lirë as në punë me shku, në rrugë -- kurrkund s’jam i lirë, prej stresit.

Py. Ky stres, të ka ndikuar edhe në shëndet? Në gjumin tënd?

Pë. Po. Po, më ka ndiku. Unë -- ndodh që as dy orë gjumë nuk i bëj kurrë, në jetën teme, prej sa ka ndodh ky rast. Edhe përpara, tash prej sa asht Gjykata Speciale, ndodh që dy orë gjumë nuk i bëj kurrë, kurrë, kurrë, kurrë. Ka net që s’fle hiç, po dy orë ka që s’fle hiç -- kurrë. Së pakut dy orë i bëj gjumë. Ma s’shumti i bëj dy orë gjumë. S’muj kurrë me flejt, kurrgjë. Veç prej stresit.

Py. Unë të besoj, po kjo mungesa e gjumit, kjo të shkatërron, të lodh. Nuk e di a mundet të na e përshkruash se si ndjehesh

mbas kësaj?
Pë. Ndihem shumë i lodhur, i pafuqishëm. Për çdo ditë të njëjtën e kam. Për çdo ditë.
Py. Faleminderit. Si ka ndikuar kjo në mënyrën se si ti e jeton jetën, a ta ka ndryshuar jetën, për shembull në ndonjë mënyrë?
Pë. Po. Po, tërësisht jeta m'u ka ndryshu.
Py. A do të doje të na e përshkruaje se si ndodh kjo, sepse ne nuk e dimë si ke jetuar përpara, pra si ke jetuar atëherë e si jeton tani. A mund të na e shpjegosh pak?
Pë. Po, muj me ta spjegu.
Para lufte jam kanë një njeri kam pas mundësi ma i lumturi në botë. Tash jam më i dobëti në botë. Nuk di qysh është me shku me dal në restorant, një muzikë, një ndejë. Nuk di qysh a *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*. Një natë të vetme nuk di qysh është me shku dikun, me u kënaq. Veç në shtëpi, gjithë në shtëpi. Çdo natë në shtëpi. Kurrë në jetë nuk jam dal deri qe tashti prej shpie, as një natë. Deri në këtë rast. E s'di qysh me t'i përshkru ma zi.
Py. Faleminderit. Na e përshkrove mjaft mirë. Faleminderit.
Dhe frika dhe stresi të kanë ndikuar edhe në punë?
Pë. Po, më kanë ndiku. Unë shkoj në orën *[REDAKTUAR]* në punë. Unë një kerr me pa mbrapa që vjen, unë ka mundësi ku me disa orë i grahi shpejt se mos po më zatet, se mos po më ndodh

diçka. Ju e dini tash edhe vetë, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* Krejt i dini, veç kam shumë
stres. Shumë.
Py. Faleminderit, zoti dëshmitar. Ne dëgjuam, mësuam edhe për *[REDAKTUAR]*. E pamë edhe certifikatën e vdekjes *[REDAKTUAR]*, më vjen keq për këtë. Mbushu me frymë njëherë, mirë.
Si janë ndjerë *[REDAKTUAR]* nga fati dhe nga vdekja e *[REDAKTUAR]*
Pë. Shumë keq. Vdekja është vdekje, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Më falni, nuk muj me përshkru se është tmerrshëm. Tmerr është. S'muj as me fol, sa keq jetojna. Deri zbardhet ky rast.
Py. Dua që ta kuptoj më mirë, kur thua "Nuk flas dot, nuk shprehem dot", çfarë do të thuash me këtë?
Pë. Kam shumë mërzi. Jam shumë i pikëllum.
Py. Faleminderit, zoti dëshmitar, faleminderit.
Më vjen por edhe pyetja tjetër mund të jetë po aq e vështirë, jo vetëm lidhur me *[REDAKTUAR]*, por edhe me *[REDAKTUAR]* Po
ata, a janë prekur nga kjo gjë? A janë ndikuar nga kjo gjë? Nëse po, si?
Pë. Po. Po, janë prekë se *[REDAKTUAR]* ma kanë kërcënue me *[REDAKTUAR]*, ma kanë kërcënu *[REDAKTUAR]* në rrugë.

Q'ajo më ka prek ma së shumti. Edhe *[REDAKTUAR]* ka ik prej shtëpie *[REDAKTUAR]*

Py. Çfarë i ndodhi *[REDAKTUAR]*, si e kanë kërcënuar?

Pë. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* unë drejtësinë kam me e çu në vend, kam me nejt n'Kosovë. *[REDAKTUAR]*

Edhe o dal prej shtëpie. Ka thanë: *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Py. Edhe vetë *[REDAKTUAR]* e kanë kërcënuar. Se ti, siç e kuptova unë, ti sapo the që të kërkuan ty të largohesh nga vendi? A e mban mend çfarë të tha *[REDAKTUAR]* se i kishin thënë?

Pë. Jo. *[REDAKTUAR]* e kanë kërcënu në emër teme. "Kujdes *[REDAKTUAR]*. Po, por më shumë nuk më ka njoftu edhe o ik.

Py. Faleminderit. Sa për të qenë të qenë të qartë, ti këtë incident e lidh me *[REDAKTUAR]* dhe me veprimtarinë tënde për të nxjerrë në dritë atë që i ndodhi *[REDAKTUAR]*? E lidh me këtë?

Pë. Po. Po. I vetmi qëllim që ky është.

Py. Faleminderit. Po *[REDAKTUAR]*? Po ata, si ndihen? Si e ndjenë ata stresin, frikën, çfarë ke parë ti?

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Py. Si pyetje e fundit. Që kur *[REDAKTUAR]* u largua për shkak të kërcënimit që përmende më parë, e ke parë më që atëherë *[REDAKTUAR]*?
Pë. Jo.
Py. Faleminderit, zoti Dëshmitar. Këto ishin pyetjet që kisha për ty. Faleminderit shumë dhe shpresoj që të qetësohesh pak më vonë.
Pë. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, Mbrojtësja e Viktimave.

Të kalojmë, ju lutem, në seancë publike tani.

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike, të nderuar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Zoti dëshmitar, e shoh që ka qenë shumë e vështirë për ty. Për momentin e kemi përfunduar pyetjet që kishte ZPS-ja, pra Prokuroria dhe Mbrojtësja e Viktimave dhe tani do ta ndërpresim punën, deri nesër në mëngjes dhe në orën 9.30 do të vijojmë. Shpresoj që do të kesh mundësi të pushosh sot pasdite dhe në mbrëmje.

Të lutem, mos e diskuto këto që ke dëshmuar këtu deri tani me askënd dhe do shihemi përsëri nesër në mëngjes.

Sekretarja do të të shoqërojë të dalësh nga salla e gjyqit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Prokuroria a ka diçka tjetër për të ngritur me Trupin Gjykues?

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, një çështje që ka të bëjë me planin e punës. Do t'ju dërgoj një email sa më shpejtë. Do të na duhet më pak kohë me dëshmitarin tjetër. Dëshmitarja 4391 -- fillimisht e kishim parashikuar dy orë marrje në pyetje. Tani mbase do të vazhdojmë një orë – një orë e gjysmë, në varësi të përgjigjeve do të japë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore. Mbrojtëse e Viktimave, keni diçka për të ngritur për Trupin Gjykues?

ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, nuk kam. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokati i Mbrojtjes? Doni të ngrini diçka me Trupin Gjykues?

Z. VON BONE: [Përkthim] Po, është një çështje krejtësisht e ndryshme për të cilën dua t'ju pyes.

Në fillim të këtij muaji patëm një dëshmitar. Kolegu mbrojtësi dhe hetuesi përkthyes nuk kishin mundësi të merrnin pjesë dhe me sa u pa nuk ishte e mundur që të lidheshim me video. Dhe nuk e di nëse do të ketë ndonjë lloj formati që të

jetë e mundur ta bëjmë këtë gjë? Pra të ketë pjesëmarrje nëpërmjet videolidhjes me Kosovën?

Nuk e di konkretisht, se si mund të bëhet, por nëse ka ndonjë mundësi për ta bërë këtë, jo tani, por në të ardhmen, do ta ndihmonte shumë. Si ta them, në qoftë se është fjala për ndonjë masë mbrojtëse apo ndonjë çështje lidhur me një vend të përshtatshëm ku mund të rrinë, a do të ishte e mundur që të ishin në një vendndodhje, në Kosovë që ta bënte të mundur lidhjen?

Nuk kemi nevojë për një përgjigje tani në këtë çast por thjesht donim ta dinim për të ardhmen nëse do të ishte e mundur, çfarë modifikime duheshin bërë, çfarë kushtesh mund ta bënin të mundur një gjë të tillë.

Kjo është e vetmja çështje që deshëm të ngrinim me ju. Kaq kishim për të thënë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, avokat i Mbrojtjes. E mbajtëm shënim kërkesën tuaj dhe do të shohim mundësinë e realizimit të një gjëje të tillë. Nëse po, në çfarë kushtesh mund të bëhej e mundur.

Z. VON BONE: [Përkthim] Për shembull, nëse ka një zyrë Prokurorie në Kosovë që mund ta bënte të mundur këtë gjë. Apo një gjykatë. Thjesht po shohim mundësinë që të mund ta bëjë të mundur një prani të tillë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, avokat i Mbrojtjes, do t’i kthehem kësaj

çështjeje.

Nëse palët nuk kanë asgjë për të ngritur për Trupin Gjykues, do të rifillojmë nesër. Falënderoj palët, Mbrojtësen e Viktimave, përkthyesit, stenografin, sigurinë, dhe ekipin teknik dhe e ndërpresim punën deri nesër në orën 9.30.

--- Seanca mbyllet një orën 14.34